



BASHKËSIA E PAQES SHPIRTËRORE



Revista Drita Islame në versionin online...

www.dritaislame.al



TEOLOGJI

BOTA JONË

REFLEKSIONE

TRASHËGIMI KULTURORE

FAMILJA

PERSONALITETE



www.dritaislame.al

“Drita islame”
Botim i Komunitetit Mysliman
të Shqipërisë

DREJTOR
Dorian Demetja

KRYEREDAKTOR
Mehmet Disha

DIZAJNI DHE FAQOSJA
Erzen Carja

KONTAKT:
Tel/fax 04 223 04 092
E-mail: info@dritaislame.al

Viti XXXII i botimit
Nr. 12 (487)
Dhjetor, 2023

ISSN 2226-7115



Artikujt
që vijnë në redaksi
dhe botohen,

nuk paraqesin domosdoshmërisht
edhe pikëpamjet e revistës.

Materialet e sjella në redaksi,
pavarësisht nëse botohen apo jo,
nuk i kthehen autorit.



PËRMBAJTJA

4 Bashkësia e paqes shpirtërore / Mehmet Disha

6 Heronjtë e konsistencës / Taulant Bica

8 Lajme / Aktivitete



12 Derisa furtuna të kthehet në fillad freskie / Elton Karaj

14 Komenti i Sures Ihlas / Lauren Luli

18 Një vit më afër, një vit më larg / Qani Sulku

20 Nëse jeta jote do të ishte një libër... / Redaksia

22 Singëriteti dhe Nijeti / Ibn Kajim el-Xheuzje

24 Mos u trishto / Mevlana Rumi

26 Biseda e Ebu Sufjanit me mbretin e Bizantit / Jetë Sahabësh



30 Rëndësia e gjuhës në jetën e një populli / Jolanda Kodra

32 Muderriz Hasan ef. Nahi (1905-1991) / Personalitet

36 Përse të rinjtë i frikësohen martesës? / Aisa Kokçi

38 Kujdesi për jetimin / Redaksia





Bashkësia e paqes shpirtërore

Paqja është kthyer në një të dashur i paarritshëm, për të cilin flitet në çdo hapësirë ku jetojnë njerëz. Në fakt, në këtë mejhane të vuajtjes, njerëzit nuk kanë ditur veçse të ankohen për mungesën e paqes dhe të këndojnë këngë të dedikuara enkas për të. Por ç'e do se të gjitha parehatitë shpirtërore që kanë hedhur shtat në çdo periudhë të historisë, e kanë bërë njerëzimin të kërkojë të periudhën e shkuar, duke e bërë nostalgjik për vuajtjen e shkuar, duke e bërë të largohet drejt "botësh imagjinare"...

Paqja shpirtërore dhe mungesa e saj, deri më sot, faqeza historisë, e cila nuk se ka qenë e patensionuar, thjesht kanë ndryshuar fytyrë, ashtu siç dita me natën i lënë vendin njëra-tjetrës, dhe paqja e vërtetë nuk ka dalë dot në dritë e plotë, duke mos e kapërcyer dot kufirin e ashpër të relativitetit. E si t'ia arrinte, kur ky vend nuk është vendi i paqes së plotë dhe të vërtetë, apo i mungesës së saj; kjo është vetëm rruga për atje. Ata që shohin dhuratat e para gjatë rrugës dhe që i ndezin qirinjtë e aftësive, duke e përdorur vullnetin plotësisht, arrijnë dritën dhe paqen shpirtërore. Në zemrat dhe ndërgjegjjet e tyre një dritë e madhe nis të shndrisë dhe paqja... Ata që nuk e kuptojnë sekretin e të ekzistuarit, që i zhvillojnë ndjesitë e tyre më të holla shpirtërore drejt ligësisë, duke u shndërruar në skllëvër të dëshirave mjerane të tyre, vetëm sa janë zhytur në errësirë, në një errësirë absolute dhe nuk kanë gjetur dot asnjëherë paqe në shpirt.

Ata që besojnë dhe që janë në rrugën e së vërtetës nuk e dinë se ç'mund të jetë mungesa e plotë e paqes shpirtërore. Ata edhe pas tensionit, apo mungesës më të vogël të rehatisë, dallojnë përherë shenjën e një shprese dhe sigurie të re, ndaj edhe i presin me buzëqeshje ngjarjet me të cilat i përball jeta.

Besim dhe shpresa janë kushti parësor i paqes shpirtërore. Kush nuk e ka arritur dot lartësimin e ndërgjegjje, duke mos e ndërtuar dot atje Xhenetin e vet, as që mund të mendohet se mund të jenë në paqe shpirtërore, e po ashtu nuk mund

të mendohet që ata që e presin të ardhmen me shpresë dhe ngrenë Parajsa të reja përditë me kënaqësitë e së ardhmes së lumtur të mos kenë paqe në shpirtat e veta.

Kësodore, të gjitha përpëlitjet tona si popull duhet të jenë për t'ia arritur qëllimit që njeriu ynë të jetë pjesë e një shoqërie të tillë të mirëqenies shpirtërore. Një shoqëri e paqes, që flatron drejt botëve të epërme e kulluar prej të gjitha ndjenjave të ulëta e të mjera... Një shoqëri e paqes shpirtërore, e përbërë nga individë që i kanë ndërgjegjjet të shkrifëta, familje që rrezatojnë veç siguri dhe gëzim dhe një popull që premton veç paqen dhe qetësinë...

Po, sepse paqja shpirtërore nis prej individit, përfton një formë tërësore të vogël me familjen, derisa merr së mbrami trajtat e nevojshme për të qenë mbizotëruese të të gjitha shtresat e shoqërisë.

Andaj, teksa mendojmë për ardhjen e së mirës, së bukurës, shpresës dhe sigurisë, jemi të detyruar që t'ia nisim punës, së pari me individin, e kjo është diçka që nuk duhet ta largojmë kurrë nga qendra e vëmendjes. Sepse, jo vetëm që është ai, individi, që do të formojë familjen, por ai do të jetë edhe shtyllë dhe pjesë e shoqërisë. Një shoqëri e përbërë prej mëkatit nuk ka se çfarë të premtojë, për sa i përket mbarësisë, suksesit, shpresës, apo lumturisë. Të gjitha mbarësitë dhe gëzimet, siguria dhe paqja shpirtërore mblidhen dhe krijojnë rrathë të mirësisë përreth individëve që kanë arritur të konceptojnë fshehtësitë e egos dhe të personalitetit, e që kanë arritur një thellësi në mendim dhe në shpirt. Njëkohësisht, ai individ që është bërë një shtyllë kaq e shëndoshë, ka përfutur në vete edhe identitetin e të qenit një pjesë shumë e mirë e familjes dhe një qytetar i përsosur.

Çerdhjet familjare që krijojnë familjet e përbëra nga individë të tillë, si personalitete të larta, të bëjnë të kujtosh qoshet e Xhenetit. Në këto vatra të lumturisë, të qenit nënë, baba, apo fëmijë, nuk fillon me lindjen dhe nuk përfundon as



me vdekjen. E përtejmeja dhe gjithë ç'ka përtej saj janë të stolisura me drita shumëngjyrëse të kësaj valleje që nuk mbaron kurrë; e zbukuruar me ngjyrat më frymëzuese, që duket sikur përfton skena të reja për çdo çast për individët që bëjnë pjesë në të. Prandaj edhe koha, e cila nuk e ka vjetëruar dot atë ngrehinë të shëndoshë, nuk do të mund t'i zbehë dot respektin dhe dhembshurinë që i lidh ata fort me njëri-tjetrin. Ajo vatër e përjetësisë veç do të vazhdojë. Kjo çerdhe kaq harmonike dhe e shëndetshme është shtylla themelore e një populli që premton të ardhme. Një popull vetëm në saje të virtutit dhe pastërtisë së kësaj shtylle mund ta shprehë ekzistencën e vetë dhe mund të bëhet më i thellë. E atëherë kur e humb këtë parim, e humb krejtësisht gjallërinë e tij. Populli që nuk ekziston brenda familjes e ka humbur vetinë e të qenit popull. Dashuria, respekti, solidariteti dhe ardhja në ndihmë njëri-tjetrit e reflektojnë ekzistencën e respektueshme të një shoqërie përmes familjes dhe një popull i këtyllë ngjitet drejt pozitave të dëshmitarit dhe mbrojtësit të paqes dhe mirëqenies shpirtërore në botë, duke u shndërruar në një element të ekuilibrit ndërkombëtar; arrin në pozitë e mbizotërimit mbi gjërat dhe ngjarjet që ndodhin.

Kjo lidhje mes gurëve të strukturës shoqërore, ndjenja e mospritmërisë dhe e të jetuarit për të tjerët në zemra dhe uniteti në edukatën e saj, bën që pjesët të lidhen aq fort me njëra-tjetrën, sa që vuajtja e përjetuar në njërin prej qelizave, bën që në të gjithë organizmin të ndihet një klithmë e thellë vajtimi; e hareja më e vogël në njërin prej pjesëve bën që organet të ndiejnë të gjitha të njëjtin gaz.

Në një shoqëri të këtyllë, masa e mban mbi supë shtetin dhe përfaqësuesit e lartë të tij. Poende shteti dhe përfaqësuesit e lartë të tij u shërbejnë popullit të tyre me krenari; një bari mëshirues, njësoj si një baba i dhimbsur, gjen gëzime dhe lumturi veçse në gëzimet dhe paqen shpirtërore të të vegjëleve të vetë, për të cilët kujdeset.

Në kësi shoqëri pronari është përherë në krah të punëtorit; në të ngrënit, të pirit dhe gjithë dëshirat e tija legjitime... si një pjesëtar familjeje, i jep atij të hajë prej asaj me të cilën ushqehet edhe vet, u mundëson edhe atyre që të veshin ato që ai vesh dhe përpiqet që të mos i ngarkojë me punë më shumë nga sa mund të përballojnë. Ndërsa punëtori, edhe ai qëndron pranë punës dhe punëdhënësit; larg prej çdo lloj ndjenje armiqësie ndaj pasurisë dhe pronarit, duke u bërë shembull i mundimit dhe përpjekjes si vlerë. Ai e di se kur është duke bërë më të mirën për një punë, apo përpiqet e stërmundohet me mish e me shpirt për të, e di se në botët e përme dhe pranë më të Drejtit ai është duke u duartrokitur dhe lëvduar për atë që po bën dhe e kryen me dëshirë gjithë ç'është duke kryer.

Shkolla, por edhe të gjitha institucionet e tjera të kësaj shoqërie, e zhvillon edhe më ndjenjën e virtutit; çel dyert për të brezi i dashurisë dhe mirësisë, duke u mësuar njerëzve se si të merren vesh dhe të mirëkuptohen me njëri-tjetrin sipas parimit të dhembshurisë dhe solidaritetit. E mbron atë prej qëllimeve të pamëshirshme, ndjenjave të poshtëruara dhe prej të rënit në pozitë e faqes së zezë të njerëzimit dhe prej çdo lloj poshtërsie tjetër; me pak fjalë, e rrit atë si një brez që di se si t'i respektojë konceptet e shenjta.

Dhe, si përfundim, në një shoqëri të këtyllë drejtësia vepron sipas filozofisë së parimit të së drejtës; bëhet përndjekësja e të padrejtësive dhe shkelësve dhe mbrojtësi i të pafajshmit dhe viktimave.

Ne, të gjithë si breza, kemi shënjë që presim për këtë bashkësi ideale dhe rrekemi të gjejmë çdo lloj zgjidhjeje që mendojmë se mund të çojë në lindjen e një lindjeje të re. Nuk e dimë se edhe për sa kohë do të rrimë e do të përpiqemi në këtë rrugë.

Heronjtë e konsistencës

Sot njerëzimi po lufton me probleme të akumuara që lidhen me jetën individuale, familjare dhe shoqërore. Fatkeqësisht, nuk është e lehtë të ndërmerren hapa afatgjatë dhe vendimtarë për zgjidhjen e këtyre problemeve. Nëse problemet në dukje të pashërueshme do të shërohen dhe problemet në dukje të pazgjidhshme do të zgjidhen, kjo do të ndodhë vetëm se me përpjekjet e heronjve të konsistencës.

Gjatë gjithë historisë njerëzore, Profetët të cilët u dërguan në shoqëri si udhërrëfyes për njerëzit, janë përpjekur pa u ndalur dhe pa bërë pushim për t'i ngritur ata në horizontin e njerëzimit të vërtetë. Edhe pse në rrugë hasën pengesa të mëdha dhe të mundimshme, ata përsëri vazhduan rrugën pa ngecur në to.

Profeti ynë (paqja qoftë mbi të) formoi një bashkësi njerëzish aq të shtrenjtë gjatë jetës së tij, sa që qëllimi i tyre ishte vetëm sinqeriteti dhe kënaqësia e Allahut. Ky sinqeritet i pastër i ngriti sahabët vertikalisht dhe i ktheu ata në heronj të konsistencës.

Para së gjithash, ata ndanë të njëjtën atmosferë me Krenarinë e Njerëzimit (paqja qoftë mbi të), u lyeu me bojën e tij dhe u bekuan me profetësinë e tij.

Së dyti, ajetet e Kuranit zbritën njëri pas tjetrit dhe ata u pastruan nën këtë shi të shpalljes. U shpallën vargje të drejtpërdrejta në lidhje me bisedat që bënin dhe ngjarjet që ndodhën midis tyre, madje edhe nga mendime që kishin në mendjet e tyre. Me fjalë të tjera, ata jetuan një

jetë nën mbikëqyrjen e vazhdueshme të shpalljes hyjnore.

Së treti, përmes dyerve të hapura nga Kurani, ata dinin të shihnin gjithçka që shpësonin dhe dëshironin të arrinin. Të gjitha këto u formuan atyre një besim të tillë, një tension të tillë metafizik, sa që nuk u tronditën as nga vështirësitë dhe as nga fatkeqësitë që u përballën, por vazhduan të ecnin në rrugën që dinin pa hezitim duke ditur se si t'i buzëqeshnin edhe më të keqes.

Kështu pra, edhe ne sot përveçse jemi të përkushtuar ndaj rrugës sonë dhe vlerave tona, duhet ta pranojmë secilin në pozicionin e vet, të mbetemi të hapur për dialog me të gjithë dhe të marrim hapa për të formuar një atmosferë paqeje të përgjithshme në botë. Përveç kësaj, ne theksojmë vlerat universale njerëzore dhe përpiqemi të takojmë njerëz me ndjenja dhe mendime të ndryshme, qoftë edhe në zona të përbashkëta. Në botën e sotme, ku argumentet që duhen përdorur për të eliminuar pengesat mes Zotit dhe njerëzve kanë ndryshuar, sukcesi varet gjithashtu nga konsistenca e qartë.

Në fakt, nga një aspekt, ne nuk i kemi përparësitë që kishin sahabët. Ndryeshe nga ata, ne jemi të privuar nga atmosfera e bekuar e të Dërguarit të Allahut (paqja qoftë mbi të) dhe nga të qenit adresuesi i parë i shpalljes hyjnore. Edhe pse mesazhet e paraqitura nga i Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të) kanë përhapur dritën në botë për shekuj të tërë dhe të cilat kanë mbijetuar edhe në kohët e sotme, përsëri mund të humbasin ndikimin, freskinë dhe



elegancën e tyre në sytë e disave prej nesh.

Megjithatë, ne kemi në dispozicion mesazhin e Kuranit, jetën dhe fjalët shembullore të Profetit tonë, përvojat dhe veprat që myslimanët kanë prodhuar me shekuj të bazuar në këto dy burime. Nëse i drejtohem Kuranit me gjithë zemër, angazhohemi vazhdimisht me të dhe si të thuash "të familjarizohemi" me Kuranin, ne mund të gjejmë gjithçka që kërkojmë dhe kemi nevojë. Sigurisht, edhe ne mund të bëhemi heronj të konsistencës nëse vërtetë i drejtohem përsëri Kuranit me gjithë zemër; duke e lexuar atë sikur të na shpallet ne; duke kuptuar shumë mirë filozofinë e jetës së Profetit (paqja qoftë mbi të) dhe duke u kujdesur për pasurinë e trashëguar nga paraardhësit tanë.

Detyra që pritet nga heronjtë e konsistencës

Përgjegjësia e rëndë që i pret këta heronj të përkushtuar Said Nursiu e përshkruan me shprehjen "riparimi i një kështjelle që ka mbetur rrënojë prej shekujsh". Fatkeqësisht, vlerat bazë që e kishin mbështetur shoqërinë Islame për disa shekuj u shkatërruan dhe gjithashtu ndodhi një deformim i tmerrshëm. Nuk mbeti respekt as për fenë e as për të shenjtën. U prishën lidhjet që i mbanin bashkë myslimanët, u prish uniteti dhe solidariteti, u harrua përgjegjësia për të ftuar njerëzit në besimin e pastër Islam.

Suksesi i këtyre heronjëve të përkushtuar që e shohin veten si përgjegjës për riparimin e kësaj kështjelle, varet

nga konsistenca e qëndrueshme e tyre. Sepse, me lejen e Allahut, nuk ka asnjë problem të pazgjidhshëm për ata të cilët e kanë arritur konsistencën e duhur në shpirtin e tyre.

Problemi nuk mund të zgjidhet kurrë duke përdorur Islamin për politikë ditore, demagogji, pretendime të mëdha, heroizma, gënjeshtër dhe mashtrime. Përkundrazi, këto do t'i përkeqësojnë akoma më shumë problemet ekzistuese. Fatkeqësisht "Islami politik", siç përdoret rëndomtë sot, e ka vrarë shpirtin e Islamit duke ia atribuuar këtë çështje retorikës dhe demagogjisë.

Në këtë aspekt, duhet ditur mirë se problemet me të cilat ballafaqohet sot bota Islame dhe njerëzimi në tërësi janë jashtë ekuilibrit. Arritja e konsistencës së dëshiruar varet nga të jetuarit me zemrë dhe shpirt, nga studimi i shkencave Islame duke marrë në konsideratë ligjin hyjnorë të krijimit shkak-pasojë. Sepse ndriçimi i ndërgjegjes varet nga drita e shkencave fetare, ndërsa ndriçimi i mendjes varet nga drita e shkencave ekzakte. E vërteta do të shfaqet vetëm kur këto të dyja bashkohen me njëra-tjetrën. Të përkushtuarit e këtij misioni të cilët jetojnë në këtë kohë, duhet të përpiqen të bashkojnë këto të vërteta të ndara prej shekujsh dhe duhet ta shohin këtë si përgjegjësia e tyre më të madhe. Vetëm atëherë mund të thuhet se rruga për zgjidhjen e problemeve të njerëzimit ka nisur.

Përktheu: Tauland Bica



1

INAUGUROHET RINDËRTIMI I XHAMISË "KODËR HANI", PUKË

U zhvillua ceremonia e inaugurimit të rindërtimit të xhamisë së vjetër të këtij fshati, e cila u çel me leximin e disa ajeteve Kuranore nga hafizi Xhemal Nuzi, për të vijuar më tej fjalën hapëse të Myftiut të Pukës, z. Gëzim Kopani.

Në fjalën e tij, myftiu Kopani, falenderoi donatorët nga Kuvajti për kontributin e tyre të vyer në rindërtimin e xhamisë së vjetër. Më tej, theksoi rëndësinë e mirëmbajtjes dhe frekuentimit të saj nga besimtarët e zonës.

Në këtë ceremoni, ishte i pranishëm gjithashtu Nënkryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Taulant Bica, i cili mbajti edhe fjalën e rastit, ku theksoi bashkëpunimin e KMSH-së dhe donatorëve nga Kuvajti për të rezlizuar këtë vepër madhore në plotësimin e nevojave të besimtarëve të zonës.

Në këtë ceremoni, përshëndetje të rastit mbajtën gjithashtu edhe Deputeti i Kuvendit të Shqipërisë, z. Lodovik Hasani, Kryetari i Bashkisë Pukë, z. Rrok Dodaj, Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz, Krye imami i KBI Prizren, z. Orhan ef. Bislimaj, Myftiu i Dibrës, z. Muis Kurtulla, Kryetari i KBI Gjakovë, z. Valon Myrta, Sekretari i parë i Ambasadës Kuvajtiane në Shqipëri, z. Adnan El Gunejm, Drejtori i Fondacionit Mirësia, z. Korab Kaja, Presidenti i Eurosig, Insig, UBA Bank, z. Kadri Morina, etj.

Në përfundim të kësaj ceremonie, të lartëpërmendurit prenë në mënyrë simbolike shiritin e inaugurimit të xhamisë së re, ku dhe falën namazin e drekës.





2

VIZITË KORTEZIE NGA KRYETARI I FORUMIT AFRIKAN PËR RELIGJIONIN DHE QEVERISJEN

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një vizitë kortezie në selinë e institucionit, z. Delanyo Adadevoh, Kryetar i Forumit Afrikan për Religjionin dhe Qeverisjen, i shoqëruar ky i fundit nga z. Ylli Doçi, Drejtori Ekzekutiv i ILF (International Leadership Foundation) për Europën.

Bashkëbisedimi ndërmjet palëve u fokusua në frymën e harmonisë ndërfetare dhe bashkëpunimit që karakterizon marrëdhënien ndërmjet institucioneve fetare në vendin tonë.

Kryetari Spahiu, pasi ju uroi mirëseardhjen të lartëpërmendurve, ndau me ta një rezymë të shkurtër të kontributit të KMSH-së dhe institucioneve në varësi të tij në ruajtjen e harmonisë ndërfetare, kultivimin e solidaritetit dhe promovimin e vlerave që synojnë përmirësimin e shoqërisë në çdo aspekt.

Ndërsa z. Adadevoh, vlerësoi angazhimin institucional dhe personal të krerëve të komuniteteve fetare të vendit tonë si mjaft të rëndësishëm në shembujt që u serviren brezave të rinj. Sipas tij, ky është kontributi më i rëndësishëm në trashëgiminë e vlerave më të larta njerëzore.

Më tej, z. Doçi, shprehu kënaqësinë e të qenit pjesë e kësaj fryme dhe kontributor i drejtpërdrejtë në këtë aspekt.

3

MBLEDHJA E KËSHILLIT TË PËRGJITHSHËM TË KOMUNITETIT MYSLIMAN TË SHQIPËRISË

Këshilli i Përgjithshëm i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë u mbledh në ambientet e Medresesë së Tiranës, ku kanë zhvilluar mbledhjen e zakonshme për 6 mujorin e dytë të vitit 2023.

Takimi u çel me leximin e disa ajeteve Kur'anore nga Drejtori i Arsimit në KMSH e njëkohësisht imami, z. Elton Karaj.

Më pas, ka vazhduar me listëprezencën, betimin e anëtarëve të rinj të këshillit, konstituimin e këshillit të përgjithshëm, Zgjedhjen e Kryetarit të KP-së, ku u rizgjidh për një tjetër mandat, z. Islam Hoxha si dhe zgjedhjen e kryetarëve dhe anëtarëve të komisioneve.

Në fjalën e tij të rastit, kryetari i KMSH-së, H. Bujar Spahiu, evidentoi përpara anëtarëve disa çështje të karakterit fetar dhe administrativ të institucionit.

Më tej, mbledhja ka vijuar me prezantimin e raportit të këshillit të mandateve dhe garancive statuore nga kancelari i KMSH-së.

Këshilli i Përgjithshëm u informua gjithashtu me vendimet që Kryesia e Komunitetit Mysliman ka marrë gjatë kësaj periudhe si dhe emërimet dhe lëvizjet e kryera që nga mbledhja e fundit, të cilat më pas janë miratuar nga KP, për të vijuar më pas me raportin e Kryesisë dhe aktiviteteve kryesore të kryetarit Spahiu.

Në raport u nënvizuan gjithashtu edhe disa prioritete të së ardhmes, për të bërë të mundur që institucioni i KMSH-së të jetë në nivelet më të larta të përfundimit dhe përgjegjësisë që mbart.

Më tej, Drejtori i Kulturës në KMSH, ndau me të pranishmit botimin më të ri të institucionit: "100 vjet Komuniteti Mysliman i Shqipërisë".





4

CEREMONIA E HAPJES SË EKSPOZITËS TRE JAVORE "KONTRIBUTI I MBRETËSISË SË ARABISË SAUDITE NË SHËRBIM TË ISLAMIT DHE MYSLIMANËVE"

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Çështjeve Fetare të Arabisë Saudite dhe nën kujdesin e Bashkisë Tiranë dhe Ambasadës së Arabisë Saudite në vendin tonë, zhvilluan ceremoninë hapëse të ekspozitës tre javore me titull: "Kontributi i Mbretësisë së Arabisë Saudite në shërbim të Islamit dhe Myslimanëve".

Në këtë ceremoni, të zhvilluar me datë 09.11.2023 pranë ambienteve të ekspozitës, të ngritura në sheshin "Skënderbej", ishin të pranishëm: H. Bujar Spahiu, kryetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Fajsal Ghazi Hifdhi, Ambasador i Mbretërisë së Arabisë Saudite në vendin tonë, z. Andi Seferi, Nënkryetar i Bashkisë Tiranë, përfaqësues të lartë të Ministrisë së Çështjeve Fetare të Arabisë Saudite, përfaqësues nga trupa diplomatike të akredituar në Tiranë, intelektualë dhe studiues të ndryshëm nga vendi e më gjerë.

Pasi prenë në mënyrë simbolike shiritin e inaugurimit në hyrje të ambienteve të kësaj ekspozite, të lartëpërmendurit vizituan nga afër standat e saj, në përbërje të të cilave ekspozoheshin elementë të ndryshëm të kulturës arabe.

Kjo ceremoni u hap me leximin e disa ajeteve të Kuranit Famëlartë, për të vijuar më tej me fjalën përshëndetëse të ambasadorit të Arabisë Saudite në Tiranë, z. Fajsal Ghazi Hifdhi.

Më tej, të pranishmit i përshëndeti gjithashtu edhe nënkryetari i bashkisë Tiranë, z. Seferi.

Ndërsa kryetari Spahiu, në fjalën e tij, veçoi kontributin e vazhdueshëm të Arabisë Saudite në vendin tonë, jo vetëm në aspektin kulturor, dëshmi e së cilës është edhe ky organizim i sotëm, por edhe në atë fetar, humanitar e social.

Në fund, ekspozita u hap për qytetarët e shumë të cilëve ndaluan të kalojnë disa çaste në ambientet e saj.





5

CEREMONIA PËRMBYLLËSE E KONKURISIT RAJONAL TË MEMORIZIMIT TË KUR'ANIT FISNIK PËR VENDET E BALLKANIT

U zhvillua në ambientet e "Tirana International Hotel", ceremonia përmbyllëse e Konkursit Rajonal të Memorizimit të Kur'anit Fisnik për vendet e Ballkanit, konkurs ky i organizuar nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë në bashkëpunim me Ministrinë e Çështjeve Fetare të Arabisë Saudite.

Në ceremoninë e mbylljes, ishin të pranishëm: Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, Ambasadori i Mbretërisë së Arabisë Saudite në vendin tonë, Sh.T.Z. Fajsal Ghazi Hifdhi, Atasheu Fetar i Arabisë Saudite në Bosnje-Hercegovinë, z. Amir al-Anezi, ambasadorë të vendeve arabe në vendin tonë, drejtues institucionesh fetare nga Ballkani dhe Evropa juglindore, përfaqësues nga ministria e lartpërmendur dhe myftinj e imamë nga rrethe të ndryshme të vendit.

Konkursi në fjalë, bëri së bashku rreth 100 konkurentë nga Ballkani dhe Evropa juglindore dhe zgjati tre ditë, i organizuar me seanca 3 orëshe, paradite dhe pasdite.

Pas leximit të disa ajeteve Kuranore, kjo ceremoni u hap me fjalën përsëritëse të Ambasadorit të Mbretërisë së Arabisë Saudite në vendin tonë, i cili, vlerësoi kontributin e të gjitha palëve që bënë të mundur realizimin e këtij projekti, duke vënë në pah rolin e vendit të tij si pararendës në unifikimin e zërave të myslimanëve në mbarë botën dhe në mbrojtjen e kauzave të tyre.

Ndërsa kryetari Spahiu, vlerësoi rëndësinë e organizimit të eventeve të tilla në shërbim të Librit të Allahut, islamit dhe myslimanëve në tërësi, duke falënderuar Mbretërinë e Arabisë Saudite për shumat e mëdha të të ardhurave që vë në shërbim ndaj Kuranit Famëlartë dhe Islamit, jo vetëm në rajonin tonë por edhe më gjerë.

Gjatë ceremonisë së sotme u shpallën fituesit për kategoritë e konkursit dhe u shpërndanë për ta çmime simbolike dhe monetare, me një total prej 50 mijë eurosh, çmime të cilat ju ndanë fituesve nga kryetari Spahiu dhe ambasadori Hifdhi.



*Derisa furturna të
kthehet në fllad
freskie...*

Fjalë të papërshtatshme, të pahijshme dhe të shëmtuara gjen ndonjëherë edhe mes besimtarëve. Detyra e besimtarit të vërtetë është të bëjë maksimumin, që këto të zhduken dhe të harrohen. Për të arritur këtë duhet durim i çeliktë.

Në radhë të parë nevojitet këndvështrimi i duhur, dhe besimtari duhet ta shohë në aspektin e sprovës në dynja. Nëse nuk e sheh kështu, atëherë do të merresh me njerëzit, do t'i përflasësh ata, do të thyesh zemra dhe do të kontribuosh për të shtuar urrejtjen dhe mllëfin. Mban mend njeri ndonjë fjalë negative apo poshtëruese të Profetit (a.s) karshi Ebu Xhehlit?

Të kontribuosh në rendin shoqëror, të ndërtosh vllazërinë mes besimtarëve dhe më gjerë, të meritosh xhenetin nuk janë synime kaq të thjeshta. Do të ketë ditë të vështira. Por krahas përlogaritjeve dhe planifikimeve të ndryshme për të ndryshuar situatën në të mirë, mundësisht çdokënd ta vlerësojmë vetëm me të mirat e tij. Kjo ndonjëherë është tmerrësisht e vështirë, sidomos kur sjelljet negative të të tjerëve pushtojnë shikimin tonë. Por nëse çdokënd e vlerëson me të këqijat e tij, rrezikon shumë që mos të gjesh vend të mirë për askënd. Prandaj s'ka zgjidhje tjetër, përveç veshit të shurdhër dhe syrit të verbuar karshi ca situatave.

PËTETA NJË PROFESORIN TIM: A KA FUND DURIMI? DHE MË THA QË DURIMI S'KA FUND. DUKEJ E HABITSHME, POR ËSHTË E VËRTETË, PËR NJË BESIMTAR DURIMI S'KA FUND. NË SHUMICËN E RASTEVE DURIMI SOS, ATËHERË KUR NJERIU VENDOS T'I JAPË PËRPARËSI NDJENJAVE, POR KJO S'MJAFTON PËR TË FITUAR SPROVËN NË DYNJA. NDONJËHERË DUKE VEPRUAR DREJTË, NDONJËHERË ME FJALËT E PËSHTATSHME KUR TË JEPET MUNDËSIA DHE NDONJËHERË TJETËR DUKE QËNDRUAR NË PRITJE QË FURUNA E TËRBUAR TË KTHEHET NË FILD FRESKIE... KËSHTU I JEP DREJTIM SITUATËS SIPAS EDUKATËS DHE KULTURËS PROFETIKE (S.A.S). E VËRTETA E MADHE E KËSAJ SJELLJEJE TË VYER PËRBALLË SHËMTIVË TË TË TJERËVE ËSHTË QË BESIMTARI S'KA PËR TË PASUR ASNJË HUMBJE, HUMB AI QË NUK SILLET PËRSHTATSHËM.

Në anën tjetër, heshtjen apo mirësjelljen dikush do ta quajë mefshtësi, mbase dikush do ta quajë frikë, por kjo s'ka rëndësi. Ata që shohin pa paragjykime do ta vlerësojnë që sot, të tjerët mbase do ta vlerësojnë kur shpirtrat e tyre të gjejnë pak qetësi. Por mbi të gjitha e vlerëson Vlerësuesi i Vërtetë, Ai që vëzhgon gjithçka.

Nëse tregohesh njerëzor, përjashto rastet që pala tjetër e ka kushtëzuar veten në urrejtje, në këmbim merr shumëfish njerëzllëk. Prandaj edhe Profeti (a.s) në këtë aspekt ka qenë shumë bujar. Ai shpërndante mirësi. Kur erdhi Ikrime (r.a), i biri i armikut më të madh të myslimanëve Ebu Xhehlit, Profeti (a.s) i tha njerëzve që kishte pranë: Mos përmendni asgjë negative të të atit. Atëherë Ikrime (r.a) nuk e kishte pranuar ende Islamit. Sapo u afrua, Profeti (a.s) hapi krahët e tij të bekuara dhe e përqafoi me ngrohtësi. Ishte Ikrime, i biri i Ebu Xhehlit, jo dikush që i kishte hedhur fjalë, por dikush që i kishte hedhur heshta e shigjeta për ta vlarë. Kjo sjellje në këmbim të jep qetësi shpirtërore, ngroh zemrat e të tjerëve dhe shumë sevape regjistrohen në fletoren e besimtarit.

"Nuk barazohet e mira me të keqen! Të keqen ktheje me të mirë e atëherë armiku yt do të të bëhet menjëherë mik i ngushtë." (Fussilet, 41:34)

"...dhe ata që durojnë për të fituar dashurinë e Zotit të tyre, që falin namazin, që ndajnë fshehurazi dhe haptazi nga ajo që ua kemi dhënë Ne dhe, që të keqen, e kthejnë me të mirë. Këtyre u takon shpërblimi në Shtëpinë e fundit: Xheneti i Adnit..." (Ra'd, 13:22-23)

"Cilësi e dalluar nuk është që të këmbesh të mirën me të mirë dhe të keqen me të keqe. Cilësi e dalluar është që të këmbesh të keqen me të mirë." (Tirmidhi, Birr, 63)

Elton Karaj

Komenti i sures Ihlas

Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirbërësit!

- 1. Thuaj: "Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm!**
- 2. Allahu është absolut, të Cilit i përgjërohet gjithçka në amshim.**
- 3. Ai as nuk lind, as nuk është i lindur.**
- 4. Dhe askush nuk është i barabartë (i krahasueshëm) ne Atë.**

Kjo sure e përbërë nga katër ajete është nga suret e para të shpallura. Emrin e merr nga tema për të cilën flet. Surja Ihlas, ashtu si surja Fatiha ka disa emra. Emrat më të njohur janë "Ihlas" dhe "kul huallahu ehad".

Emërtohet me emrin "Ihlas" për arsyen se shpjegon "Teuhidin", që është baza e mirëfilltë e besimit në mënyrën më të përmbledhur.

Besimi dhe njësimi i Allahut xh.sh. nuk është shpjeguar kaq qartë në asnjë libër tjetër veç Kuranit dhe në asnjë fe tjetër veç Islamit. Allahu në këtë sure refuzon kategorikisht çdo lloj shirku (të bërit shok Allahut) ndaj Tij.

Kjo sure është emërtuar edhe me emrat si: "teuhid"/"shpëtim", "lindje", "njohje" etj. Është emërtuar me këto emra për arsyen se nëse përbërja e saj do të kuptohej e do të njihje saktë, atëherë do të njihje Allahu xh.sh.

Njihet edhe si "Surja Nur", pasi Profeti a.s. ka thënë: "Çdo gjë e ka një dritë, ndërsa drita e Kuranit është surja 'Kul huallahu ehad'"¹.

Koha e zbritjes

Në lidhje me çështjen se kjo sure ka zbritur në Mekë apo Medinë, merren paralelisht dy hadithet që flasin për qëllimin e zbritjes së saj. Si përfundim dalin në pah dy mendime: disa komentues janë munduar të gjejnë rrugën e mesme dukë thënë se shpallja e kësaj sureje është përsëritur.

Qëllimi i Zbritjes

Ata të cilët thonë se kjo sure ka zbritur si përgjigje për mohuesit, transmetojnë këto argumente:

Transmetohet nga İkrima se një ditë mohuesit pyetën Profetin a.s.: "Na informo për Zotin Tënd, na përshkruaj veçoritë e Tij, çfarë është dhe pse është?" Allahu si përgjigje zbriti këtë sure deri në fund.

Ndërsa argumenti i atyre që thonë se kjo sure ka zbritur si përgjigje për hebretë është

1. Alusi, Ruhu'l-Meani, XXX, 266.

se një ditë një delegacion vjen te Profeti a.s. dhe e pyesin: "O Muhamed! Allahu krijoi çdo gjallesë, po Allahun kush e krijoi?" Pasi dëgjo këto pyetje, Profeti a.s. u mërzi shumë ndaj tyre që po pyesnin diçka të tillë në lidhje me Allahun. Kur tentoi t'i qortonte ata për pyetjen e bërë, erdhi Xhebraili dhe e qetësoi duke i thënë: "Mbështilli ata me krahët e butësisë", pra bëhu i butë dhe i durueshëm o i Dërguari i Allahut. Allahu u dërgoi atyre përgjigje për çfarë pyetën.

Sipas mendimit të Raziut, surja Ihlas ka zbritur si përgjigje e pyetjeve të krishterëve.²

Koment:

1. Thuaj: "Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm!

Këto fjale i drejtohen në radhë të parë Profetit a.s. në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe pastaj gjithë njerëzimit. Meqë urdhri është i prerë dhe i drejtpërdrejtë, tregon se ai duhet transmetuar te të tjerët në të njëjtën formë. Pra, të vërtetat që Allahu xh.sh. ka treguar në këtë sure janë padyshim fjaltet e Allahut. Kështu që, ti o i Dërguari i Allahut, pa asnjë dyshim dhe me siguri të plotë nguliti fort në zemër, përsëriti shumë dhe transmetoju te të tjerët haptazi, që t'i njohin të gjithë.

Ai që meriton me të drejtë adhurimin është Allahu, një i vetëm dhe s'ka tjetër veç Tij. Fjala "Ehad" ka kuptimin një. Megjithëse përdoret dhe në kuptimin "Uahid", midis dytributeve ka një ndryshim të rëndësishëm. Fjala Uahid, ka kuptimin e përjashtimit dhe vjen në formën më të qartë të fjalës dhe ka kuptim numëror. Kështu që në brendësi të saj mund të ketë kuptimin e dobësisë. Ndërsa fjala Ehad, nuk pranon as copëzim e as barazi me diçka tjetër. Nuk pranon një të dytë që mund t'i afrohet sadopak, është një pamundësi e një të dyti dhe përjetësisht do të vazhdojë të jetë po ashtu. Pra, kur themi "Allahu është Një", themi që Allahu me emrat, veçoritë dhe atributet e Tij është një, pa shok dhe i pazëvendësueshëm. Prandaj adhurimi i përket vetëm Atij dhe asgjëje tjetër. Pra në çdo formë dhe mënyrë Allahu është një dhe i vetëm, Ai është dhe do të jetë dhe me të nuk ka dhe s'do të ketë asgjë. Imam Ebu Hanife, në librin e tij el-Fikhul-Ekber, këtë çështje e përmbledh shkurtimisht kështu: "Allahu i madhëruar është një nga që nuk ka të njëjtë, të përngjashëm, shok e jo nga aspekti numerik."

2. Fahu'r-Razi, et-Tefsiru'l-Kebir, XXXII, 175.

2. Allahu është absolut, të Cilit i përgjërohet gjithçka në amshim

Allahu është i plotfuqishmi dhe çdo gjë ka nevojë për mbështetjen e Tij. Me të vërtetë Ai është fuqia ku njeriu mund të mbështetet për çdo gjë. Në lidhje me kuptimin e atributit "Samed" transmetohet nga Ebu Hurejra se ka thënë: "Allahu nuk ka nevojë për askënd dhe çdo gjë është nevojtare për Të".³

3. Ai as nuk lind, as nuk është i lindur.

As nuk ka lindur ndonjërin e as nuk është i lindur nga dikush. Pra nuk ka lindur nga dikush tjetër ashtu si linden gjallesat nga një nënë dhe nuk ka lindur askënd tjetër e të bëhët nënë. Ai s'ka fillim e mbarim dhe nuk është ndër qeniet e tjera që janë krijuar më vonë. Allahu nuk është as baba e nënë që lind dhe as fëmijë i lindur. Ajo krijesë që ka këto veçori jo vetëm që nuk mund të jetë Zot, por nuk mund ti jepet as një mundësi e vogël për këtë. Sepse ai që lind dikë do të ketë nevojë për dikë tjetër dhe ai që lind nga dikush tjetër nuk mund të jetë i përgjeshëm, por me një fillim dhe mbarim.

Ky ajet i kthen përgjigje dhe i kundërshton të gjithë hebrenjtë që thoshin: "Uzejri është biri i Allahut" (Teube, 9/30); të Krishterëve që thoshin: "Mesihu është biri i Allahut" (Teube, 9/30); mohuesve të Mekës që thoshin: "Engjëjt janë vajzat e Allahut" (Nahl, 16/57).

Këtë Allahu e ka sqaruar edhe në një sure tjetër: "Ai është Krijuesi i qiejve dhe i tokës! E si mund të ketë Ai fëmijë, ndërkohë që nuk ka bashkëshorte!? Ai ka krijuar çdo gjë dhe ka dijeni për çdo gjë." (En'am,6/101)

3. Alusi, Ruhul-Meani, XXX, 274.

4. Dhe askush nuk është i barabartë (i krahasueshëm) ne Atë.

"Kufuv" ka kuptimin e të qenurit i barabartë në masë dhe vlerë dhe kjo kupton të pasurit shok dhe të ngjashmin me veten. Por që Allahut nuk mund t'i bëhet shok asnjë krijesë në çfarëdolloj veçorie dhe atributi.

Pra është e pamundur që Allahut të ketë rival, qenie e njëjtë, e kundërt, bashkëpunëtor apo kundërshtar në formë, veçori, attribute apo vepra të tij.

Disa hadithe në lidhje me virtytet e kësaj sureje

I dërguari i Allahut ka thënë se leximi i sures Ihlas është i barabartë me leximin e një të tretës së Kuranit: "A e ka ndonjëri nga ju të pamundur leximin e një të tretës së Kuranit brenda një nate?" Kjo u duk e vështirë për shokët e Profetit a.s. "Atëherë dijeni se leximi i sures Ihlas është e barabartë me leximin e një të tretës së Kuranit."⁴

Ndërsa në një hadith tjetër, i Dërguari i Allahut thotë: "Ai i cili lexon një herë suren Ihlas, është shpërblyer nga Allahu njësoj sikur ka lexuar një të tretën e Kuranit, ai i cili lexon dy herë është shpërblyer nga Allahu njësoj sikur të ketë lexuar dy të tretën e Kuranit dhe ai i cili lexon tre herë është shpërblyer nga Allahu njësoj sikur të ketë lexuar gjithë Kuranin."⁵

Lauren Luli

4. Buhari, Fedailu'l-Kur'an 13, Tevhit 1; Muslim, Musafirin 259, 261.

5. Muslim, Musafirin 259.



Një vit më afër, një vit më larg



Çdo vit i përngjan një arkivi, i cili dokumenton në mënyrë të detajuar gjithçka kemi bërë. Çdo vit i përngjan një ditari, të cilin, duam apo nuk duam, na e mban tjetërkush, i cili është i ngarkuar vetëm për atë punë. Madje nuk është një, por janë dy shoqëruar, të cilët nuk na ndahen për asnjë moment, gjatë ditënatës, dy engjëj të ngarkuar nga Zoti i gjithësisë për të shënuar çdo vepër të njerëzisë. Ditari ynë ndryshon nga ditari që përgatisin këta dy shkruar, pasi ditarin tonë e shkruajmë vetë, ashtu siç duam dhe siç e ndiejmë, dhe nëse nuk na pëlqen, e grisim një faqe dhe shkruajmë në tjetrën, ndërsa ditari i tyre nuk bëhet sipas dëshirave e ndjenjave, por në bazë të punëve tona. Ai ditar nuk fshihet, por ruhet me shumë kujdes, për t'u shfaqur në një ditë shumë të madhe, e cila ndryshe mund të quhet: "Panairi i veprave të njerëzimit".

Ditarët që shkruajmë vetë, ndodh që t'i mbajmë fshehur, që të mos bien në duart e të tjerëve, me qëllim që të mos zbulohen ndjenjat, qëllimet, punët që i bëjmë larg syve të të tjerëve, por harrojmë ditarin tjetër që do të publikohet në një ditë ku të gjithë do të jenë protagonistë të një ekspozite, punimet e së cilës do të shihen nga të gjithë, edhe pse gjithsecili do të jetë i zënë, se si do të pritet punimi i tij nga juria e cila përbëhet nga i Vetmi dhe i Pazëvendësueshmi, nga Lartmadhëria e Tij, të Cilët i përulen çka ka në qiej e në tokë, Allahu xh.sh.

Tanimë që jemi në fund të vitit, a jemi të gatshëm të hapim arkivin/ditarin tonë? A jemi të gatshëm të rikthejmë shiritin e kasetës sonë vjetore dhe të xhirojmë së prapthi punët e një viti? Do të donim ta bënim këtë në praninë e dikujt tjetër, apo do të donim të ishim vetëm? Sa krenarë apo sa të turpëruar do të ndiheshim pasi të rifreskonim edhe njëherë në kujtesën tonë, atë që gjuhët thanë e atë që duart dhe këmbët punuan përgjatë një viti? Sigurisht që këto janë pyetje retorike, të cilat zgjojnë ndërgjegjen e gjithkujt, nëse ka një të tillë, me qëllim që ta kuptojë se ku gaboi e ku fitoi. Në jetë ka humbje dhe fitore, kështu që duhet parë probabiliteti drejt cilës anë peshorja anon.

Kaloi dhe një vit. Tashmë jemi një vit më afër botës tjetër, një vit më larg kësaj që jetojmë. Një vit më afër përjetësisë dhe një vit më larg përkohshmërisë. U larguan prej nesh plot 365 ditë e net, plot 365 mëngjes e mbrëmje, plot 365 agime e perëndime, mbi të gjitha, pa na pyetur fare.

Në çdo fundvit, secili prej nesh duhet ta pyesë veten: Ky vit si më rezultoi? Një vit më pranë të mirës dhe më larg së keqes dhe ligësisë, apo e kundërta? Gjatë vitit që lamë pas, sa pranë Zotit kemi qenë, apo u bëmë si ata që harruan Zotin e tyre dhe Ai i harroi?! Kujt i dhamë përparësi: botës tjetër, që çdo ditë po na pret, apo kësaj dynjaje, që mijërave si unë dhe si ti po i përshëndet dhe lamtumirën po u jep? Kë patëm udhërrëfyes: Kur'anin apo Shejtanin?

Sa njerëz na u afruan dhe sa prej atyre që kishim pranë na u larguan? Çfarë na lumturoi dhe çfarë na brengosi? Dikush me të drejtë mund të pyesë: për çfarë shërbejnë kaq shumë pyetje? Përgjigja është: që të marrësh rezultatin, nëse ke pasur një vit të suksesshëm apo të dështuar, sepse mund të ndodhë që ajo që ti e konsideron sukses, në realitet mund të jetë dështim.

Në 12 muaj, sa u lartësuam dhe sa e ulëm veten? Sa u ndjemë krenarë me atë që bëmë? A qëndruam brenda kufijve të njerëzores apo tejkaluam çdo limit, saqë edhe botës shtazarake dhe kafshërore i vjen turp prej nesh? Çfarë gjurmësh lamë dhe a ia vlen që dikush t'i ndjekë ato? A ishte ky vit më afër paqes dhe shumë larg luftës? Sa gjakderdhje pati? Sa foshnja engjëllore ende pa nisur rrugëtimin e tyre të jetës, dora gjakatare i largoi nga gjiri i nënave dhe ia dorëzoi dheut të ftohtë? Sa nëna me shpirt vajtuan; sa shtëpi u rrënuan; sa familje morën rrugën në drejtim të paditur për t'i shpëtuar vdekjes, pasi në vendin e tyre siguri nuk shijuan? Përgjigjet fatkeqësisht nuk janë shpresëdhënëse, përkundrazi, alarmante. Një vit me mijëra të pafajshëm të vrarë, një vit me vende të shkatërruara, një vit ku fjala paqe u shfaq më shumë në ëndërr sesa në realitet; një vit ku bota është nisur në drejtim të gabuar dhe nuk di të ndalet. Kush do ta ndalë të keqen, që këtë vit ka vërshuar si një uragan? Kush do ta ndalë luftën, këtë kuçedër që gllabëroi mizorisht jetë dhe shpresë njerëzish më shumë se çdo vit tjetër?

Fundviti është një ndalesë ku secili duhet të bëjë një vetërrëfim të çiltër e të singertë, një bashkëbisedim me veten, e cila të njeh më mirë se të tjerët. Dhe pas një viti vjen një tjetër. Ashtu siç pas një nate presim agimin e një dite të re, për të cilën projektojmë dhe planifikojmë se si do ta çojmë, ashtu edhe për vitin e ri, duhet t'i vëmë vetes qëllime sublime dhe për to të punojmë fort për t'i realizuar.

Janë të njohura fjalët e urta "Ditë më të mira do të vijnë" apo "Ditë më të mira presim", por ato nuk mund të vijnë e as nuk duhet t'i presim, pasi Zoti nuk e ndryshon gjendjen e një populli nëse vetë ata nuk përipiqen për ta ndryshuar për mirë gjendjen e tyre. Kështu që, le të punojmë për ditë më të mira, që ato të vijnë.

Viti i ri le të jetë një fillim i ri, një stacion i ri, një faqe e re e mbushur plot shpresë e gëzim, prosperitet e mirëqenie, dashuri e vëllazëri, besim e përkushtim, paqe e mirëkuptim, falënderim e mirënjohje, falje e mëshirë.

Le të jetë ky vit i ri, viti që prisnit për çdo dëshirë e çdo qëllim dhe mos harroni: çdo vit është një vit më afër, ose një vit më larg, e gjitha varet nga ne.

Qani Sulku

NËSE JETA JOTE DO TË ISHTE NJË LIBËR...

Nëse jeta jote do të ishte një libër, çfarë vendi do t'i rezervoje asaj te libreria e shpirtit tënd, mes librave filozofikë, enciklopedikë, romantikë, poetikë apo shpirtërorë? Do të doje ta vendosje në një vend të dukshëm apo në një vend ku nuk do të mund ta gjenin as edhe kërkuesit më të vëmendshëm? Do ta lexoje shpesh apo vetëm një herë në muaj, në vit, në mos do ta merrje në dorë vetëm për t'i fshirë pluhurat? Apo do ta vërvitje në një qoshe, ku të kishe mundësi që ta harroje?

Ç'do të ndieje në qoftë se një lexues do ta përthyente faqen e librit në vendet më të dëshpëruara apo në ato më të gëzuara, për më tepër, në ato vende ku shkruhet: "Gjërat që i kam jetuar për herë të parë në jetën time?" Ç'do t'i thojë lexuesve që, pasi të kishin mbaruar së lexuari, do të buzëqeshnin për momentet e tua të dëshpëruara dhe do të mërzhiteshin për ato të gëzuara, apo nuk do t'i kishin kuptuar momentet e tua

më interesante? Ç'do t'i thojë atyre që do të mendonin një përfundim të keq kur ti ishe konfuz? Do të të vinte keq për veten dhe do të doje që t'i jetoje ndryshe përsëri momentet që nuk do të pëlqenin? Apo do të qëndroje indiferent kundrejt çdo gjëje?

Do të mërzhiteshe po të shikoje dikë që do t'i interesonte trashësia e librit e jo përmbajtja e tij? Do t'i buzëqeshje atyre që do të merreshin me madhësinë e shkronjave apo me gjatësinë e fjalëve, ndërkohë që ti je ai që i ka jetuar germë për germë e fjalë për fjalë ato rreshta? Do t'i shikoje me vëmendje ata që do të prisnin plot emocion fundin e librit?

Nëse jeta jote do të ishte një vepër, ti si një shkrimtar, cilën prej pjesëve të saj do të pëlqejë? Cilat prej faqeve do t'i grisje e do t'i hidhje poshtë, cilat prej vargjeve do t'i nënvizojë e do t'i lexojë disa herë, cilat momente do të doje t'i jetoje edhe një herë? A do të ishte jeta jote e



kënaqur duke qenë libër dhe a do të ishte libri i kënaqur duke qenë jeta jote? Do ta shtypje për herë të dytë, të tretë e pastaj për të katërtën herë? Apo mos ndoshta do ta lije në raft për vite me radhë si një gjë të pavlerë?

Do t'i kushtojë rëndësi kopertinës së librit? Do të doje që fletët e tij të ishin nga më të shtrenjtat? Apo do të mjaftoheshe me disa fletë prej kashte? Ç'figurë do t'i vendosje kopertinës? Një portret të qeshur, një që qan apo një që ka kthyer shpinën e po ikën? Po librit, çfarë titulli do t'i vendosje: "Jeta ime", "Kujtimet e mia", "Të vërtetat e mia", "Gabimet e mia", "Sa e shkurtër qenka jeta?!" apo...

Dhe më e rëndësishmja nga të tëra, cili do të ishte ndryshimi nga librat e tjerë, çfarë do të tregojë më shumë, ç'ngjarje të ndryshme do të theksojë nga librat e tjerë, çfarë do ta shikojë si të parëndësishme dhe do ta kalojë? Çfarë do t'i mësonite lexuesit përmbajtja e librit,

çfarë morali do të nxirrte ai nga ky libër? Cila do të ishte pjesa më e mirë... fillimi, mesi, fundi i rrugës apo asnjëra?

Çfarë fuqie shprehëse do të kishin fjalët e shkruara në të? Apo çdo fjalë do të ishte shkruar me gjuhën e zemrës? Nëse jeta jote do të ishte një libër, a do ta pëlqejë atë libër? A do të ishte ai libri më i preferuar? A do të citoje fraza nga ai kur të flisje? Apo do ta mohojë e do të kishe turp nga ato që ke jetuar?

Nëse jeta jote do të ishte një libër, a do të ishte e përmbledhur jeta aty, apo fletët e jetës do të ishin si fletët e librave seri që nuk u dihet numri?

Nëse jeta jote do të ishte një libër...

Redaksia

Sinqeriteti dhe nijeti

Sinqeriteti është të pastruarit e qëllimeve pas veprave për t'iu afruar më shumë Allahut. Është të siguarit se qëllimet e adhurimit dhe bindjes ndaj Allahut nuk janë vetëm se për kënaqësinë e Tij. Është përsiatja e vazhdueshme mbi Krijuesin aq sa harrohen krijesat. Sinqeriteti është kusht që Allahu t'i pranojë veprat e kryera në përputhje me sunetin e të Dërguarit të Tij, paqja qoftë mbi të. Këtë Ai e urdhëron në Kur'an: "Ata nuk u urdhëruan vetëm se të adhuronin Allahun duke qenë të sinqertë në fenë e Tij" (Kur'ani, 98:5). Ebu Umame transmeton se një njeri erdhi te Profeti a.s. dhe i tha: "Si do të bëhet me atë njeri që shkon në betejë duke synuar famën dhe plaçkën e luftës?" Profeti a.s. iu përgjigj: "Ai nuk do të marrë asnjë shpërblim". Ai njeri ia përsëriti tri herë pyetjen dhe çdo herë përgjigja ishte: "Ai nuk do të marrë asnjë shpërblim". Pastaj Profeti a.s. shtoi: "Allahu pranon vetëm ato vepra që kryhen tërësisht për kënaqësinë e Tij". Ebu Seid el Hudri transmeton gjithashtu se gjatë hytbes në haxhin e lamtumirës, Profeti a.s. ka thënë: "Allahu do ta bekojë cilindo që i dëgjon këto fjalë dhe cilindo që i kupton ato e më pas i kumton, sepse mundet që atyre që u kumtohet kjo dije të jenë ata që do ta kuptojnë atë më së miri. Ekzistojnë tre gjëra lidhur me të cilat zemra e një besimtarit nuk duhet të ndiejë armiqësi apo keqdashje: përkushtimi i veprave Allahut, dhënia e këshillës udhëheqësve të myslimanëve dhe besnikëria ndaj shumicës". Ajo që nënkuptohet këtu është se këto tre gjëra e forcojnë zemrën dhe cilido që përqendrohet në to do të ketë një zemër të pastër nga çdo formë mashtrimi, kalbëzimi dhe mëkati. Një njeri mund ta çlirojë plotësisht veten e tij prej shejtanit vetëm nëpërmjet përkushtimit të sinqertë. Allahu na tregon në Kur'an se Iblisi i tha Atij: "...Përveç robve të Tu që janë të sinqertë" (38:83). Kur ndonjë pasuri e kësaj bote, tek e cila anon zemra dhe egoja gjen rehati, ndërhyjnë në adhurimin tonë, atëherë pastërtia dhe sinqeriteti i përpjekjeve tona dëmtohet. Kjo ngaqë njeriu preokupohet me pasurinë e tij dhe përhumbet në plotësimin e dëshirave e qejfeve, veprat e adhurimit e tij rrallëherë janë të pastra nga qëllimet dhe dëshirat e përkohshme të kësaj natyre.

Devotshmëria është të pastruarit e zemrës nga të gjitha papastërtitë, të pakta apo të shumta qofshin, në mënyrë që qëllimi i të afruarit tek Allahu të jetë i pastër nga të gjitha

shtysat e tjera përveç kërkimit të kënaqësisë së Tij. Kjo arrihet vetëm nga ai që e dashuron Allahun, që është kaq i përpirë në përsiatjen e botës tjetër saqë në zemrën e tij nuk ka vend për dashurinë e kësaj bote. Një njeri i tillë është i sinqertë dhe përqendrohet me devotshmëri tek të gjitha veprimet e tij deri edhe në të ngrënët, të pirët apo në kryerjen e nevojave fiziologjike. Me përjashtime të rralla, çdokush që nuk është i tillë do ta gjejë të mbyllur para tij derën e devotshmërisë. Veprimet e përditshme të një njeriu tek i cili mbizotëron dashuria për Allahun dhe botën tjetër duhet të pasqyrojnë këtë dashuri, dhe kjo do të ishte devotshmëria e kulluar. Po njësoj, nëse shpirtin e dikujt e ka kapluar dashuria dhe shqetësimet e kësaj bote, ai do të rrëmbehet kaq shumë pas këtyre gjërave sa adhurimet e tij nuk do të jenë të pranueshme vetëm se në raste të rralla. Kurimi i dëshirave e qejfeve të kësaj bote është që ato të kontrollohen duke i dhënë fund lakmisë për këtë botë dhe duke e pastruar e përgatitur veten për botën tjetër. Kjo, më pas, do të bëhet një shprehje e zemrës dhe njeriu do ta ketë më kollaj që ta bëjë devotshmërinë gjendje të përhershme të vetes së tij. Shumë vepra të cilat njeriu mendon se i kryen për kënaqësinë e Allahut nuk janë të tilla, sepse ai nuk arrin të shohë të metat e tyre. Tregohet se dikush e kishte zakon të falej rregullisht në rreshtin e parë të faljes. Kur një ditë erdhi me vonesë, u fal në rreshtin e dytë. Duke e ndjerë veten ngushtë kur njerëzit e panë në rreshtin e dytë, ai kuptoi se kënaqësinë dhe këndjen e zemrës që ai provonte nga të falurit në rreshtin e parë vinin si pasojë e admirimit të njerëzve kur e shihnin aty. Kjo është një çështje mjaft e hollë dhe delikate ndaj së cilës gjithsekush duhet të jetë i vëmendshëm. Es-Susi ka thënë: "Devotshmëria e vërtetë është mungesa e vetëdijes për devotshmërinë tënde, sepse ai që vë re devotshmëri në devotshmërinë e tij është një njeri devotshmëria e të cilit ka nevojë për devotshmëri". Të mjaftohesh i kënaqur me devotshmërinë tënde do të thotë të vetadmirohesh dhe vetadmirimi është sëmundje e zemrës, ndërkohë që e përsosura dhe e pastërta është pa asnjë mangësi.

Veprat duhet të pastrohen nga çfarëdolloj vetadmirimi në lidhje me plotësimin dhe kryerjen e tyre. Një i ditur ka thënë: "Njerëzit e kanë më të vështirë të pastrojnë qëllimet sesa

të kryejnë veprat". Kur dikush u pyet se cila ishte gjëja më e vështirë për egon, ai u përgjigj: "Devotshmëria kur egoja nuk ka fatin e mirë të jetë pajisur me të". Të veprosh për hir të admirimit të tyre do të thotë t'i shoqërosh të tjerë Allahut. Devotshmëria është kur Allahu të çliron nga të dyja këto gjendje".

II

Natyra e qëllimit

Qëllimi i një njeriu nuk është shqiptimi i fjalëve, "Kam për qëllim të bëj këtë e këtë". Është një vërshim i frymëzuar nga Allahu që kaplon të gjithë zemrën. Disa herë është i kollajtë, herë të tjera paksa i vështirë. Një njeri, zemra e të cilit është tërësisht e nënshtruar, e ka të kollajtë t'i pastrojë qëllimet çdoherë. Zemra e një njeriu të tillë gjithmonë priret drejt rrënjëve të mirësisë, të cilat lulëzojnë me kryerjen e veprave të mira. Sa për ata, zemrat e të cilave anohen dhe përfshihen nga çështjet e kësaj bote, do ta kenë të vështirë t'i pastrojnë qëllimet, madje edhe adhurimet e përhershme mund t'u vështirësohen e t'u bëhet e mundimshme kryerja e tyre. Profeti a.s. na rrëfen: "Veprat gjykohen sipas qëllimeve, dhe gjithsecili do të shpërblehet sipas asaj që ka pasur qëllim. Kështu, ai që është shpërngulur për hir të Allahut dhe të dërguarit të Tij, ajo shpërngulje do të shpërblehet sikur të jetë bërë për Allahun dhe të Dërguarin e tij. Shpërngulja e kujt ka qenë për ndonjë interes të kësaj bote apo për t'u martuar, shpërngulja e tij do të jetë për atë qëllim që ka pasur." Imam Shafiu për këtë hadith thotë se "...është një e treta e dijës". Fjalët "veprat gjykohen sipas qëllimeve", kanë kuptimin që veprat e kryera në përputhje me sunetin do të pranohen dhe shpërblehen vetëm nëse qëllimi në kryerjen e tyre është i sinqertë. Ashtu si edhe fjalët "gjithsecili do të shpërblehet sipas asaj që ka pasur si qëllim", do të thotë se shpërblimi për një vepër varet nga qëllimi për të. Pasi e thekson këtë parim, Profeti a.s. na tregon shembuj duke thënë: "Ai që është shpërngulur për hir të Allahut dhe të dërguarit të Tij, ajo shpërngulje do të shpërblehet sikur të jetë bërë për Allahun dhe të dërguarin e tij. Shpërngulja e kujt ka qenë për ndonjë interes të kësaj bote apo për t'u martuar, shpërngulja e tij do të jetë për atë qëllim që e ka kryer". Kështu pra, vepra që në dukje janë të ngjashme, mund të jenë të ndryshme, sepse qëllimet për kryerjen e tyre

ndryshojnë në gradë mirësie dhe ligësie, nga një njeri tek tjetri. Qëllimet e mira nuk e ndryshojnë natyrën e veprave të këqija. Injoranti nuk duhet ta keqinterpretojë domethënien e hadithit e të mendojë se qëllimet e mira mund t'i bëjnë të pranueshme veprat e liga. Thënia e mësipërme e Profetit a.s. lidhet posaçërisht me kryerjen e adhurimeve dhe veprat që janë të lejueshme, por jo me të ndaluarat. Adhurimi dhe veprat e lejuara mund të kthehen në të ndaluara për shkak të qëllimeve pas tyre, (domethënë nëse kanë tjetër qëllim përveç kënaqjes së Allahut) dhe veprat e lejuara mund të shndërohen në të mira apo të liga, varen nga qëllimi për kryerjen e tyre. Çdo vepër e lëndueshme duhet t'i ketë rrënjët në qëllimin e sinqertë; vetëm atëherë mund ta meritojë shpërblimin. Parimi thelbësor duhet të jetë që vepra të kryhet si adhurim vetëm ndaj Allahut të Madhërishëm. Nëse qëllimi është mburrja, kapardisja, atëherë këto vepra adhurimi do të shndërohen në vepra mosbindjeje. Sa për veprat e lejuara, ato të gjitha kryhen për qëllime të caktuara që mund t'i kthejnë ato në vepra të mira e që mund ta afrojnë njeriun me Allahun e t'i sigurojnë atij të mirat e kësaj afërsie me Të.

Rëndësia e qëllimeve

Omer bin el Hatab r.a. ka thënë: "Nga veprat, më e mira është të bësh atë që ka urdhëruar Allahu, të largohesh nga ajo që Ai ka ndaluar dhe të kesh qëllime të sinqerta kundrejt gjithçkaje që Allahu ka kërkuar prej nesh". Disa prej të parëve tanë kanë thënë: "Shumë prej veprave të vogla bëhen të mëdha nga qëllimet për kryerjen e tyre. E nga ana tjetër, shumë vepra të mëdha, zvogëlohen për shkak të qëllimeve të mangëta për kryerjen e tyre". Një njeri i urtë ka thënë: "Mësoni për qëllimet, sepse rëndësia e tyre është më e madhe se rëndësia e veprave". Ibn Omeri njëherë dëgjoi një njeri i cili duke veshur ihramin e tij thoshte: "O Allah, qëllimi im është të bëj Haxhin dhe Umren". Pasi e dëgjoi, ai iu drejtua kështu atij njeriu: "Kjo që po bën, a nuk është në fakt për t'i njoftuar njerëzit për qëllimin tënd?! Mendon se Allahu nuk i di qëllimet në zemrën tënde?!"

Qëllimet janë tërësisht një preokupim i zemrës e nuk duhet të pëshpëriten gjatë adhurimeve.

Mos u trishto

VARGJE NGA

MEVLANA XHELALEDDIN RUMI

La tahzen!
Nëse njerëzit ta thyen zemrën, mos u trishto;
Zoti, a s'thotë:
Gjemëni brenda zemrave të thyera!
Atëherë, pse duhet të mërzitesh, o shpirt?!

Në dëshirofsh të rrezëllesh si dritë e agsholeve,
Duhet më parë egon e muzgët ta shuash.
Thua: "Kam brenga plot!",
Por ti nuk e di se brengat janë bartëse
që e çojnë njeriun drejt e drejt tek Zoti.
Mos kujto se je i vetmi i brengosur,
Por dije:
Ka njerëz të cilët, të njëjtin shqetësim që ke ti,
E quajnë mirësi.

Mos i thërrmo shpresat: sille ndërmend Jusufin,
Kudo që fle dhimbja, atje shkon shërimi;
Kudo që ndodhet skamja, atje rend furnizimi,
kudo që ngrihet pyetja, atje mbin përgjigja,
kudo që të ndodhet anija, atje gjendet ujët.

Rend pas ujit, bëhu i etur dhe shih se si
Nga çdo anë do të vërshojnë ujërat prej nëndhesës.
Pasuria e kësobote është buzëqeshja e Zotit,
Kundroje pasurinë,
Por mos u deh prej saj.

Mos u trishto!
Një burim nuk e nxë dot një det, e as deti nuk e nxë
dot një oqean.
Kush nuk ka dashuruar, nuk mund ta kuptojë "ç'jam
Unë", "ç'je Ti";
Dhe po të thuash që kjo rrugë
Është e duhura që të çon tek Zoti,
Kurrkush s'të beson.
Një shpirt që nuk mbart as edhe një grimcë prej "dielli",
S'digjet dot, e as që mund të ndizet!

Mos u trishto për shkak se për një çast t'u thye
këmba;
Ndoshta Zoti, në vend të këmbës që të mori,
do të të japë krahë për të fluturuar!
Mos u trishto nëse ke ngecur në fund të një pusi;



Mos harro:
Jusufi u nxor nga fundi i një pusi dhe filltas u bë mbret
i Egjiptit.

Në t'u plotësoftë një dëshirë, do kesh veç një mirësi
prej saj,

E në s't'u plotësoftë, do gjesh njëmijë mirësi pas.

E shkuara dhe e ardhmja varen prej njeriut,
Porse e vërteta e universit është një e vetme:
Ky univers është ëndërr.

Mos bjer pre e dyshimeve, shpirti im.

Nëse në ëndërr të pritet njëra dorë, mos u mërzit,

Ngase dora është sërish në vendin e saj.

E meqënëse kjo botë është ëndërr,

Atëherë edhe fatkeqësitë që të zënë janë kalimtare.

E pse duhet të mërzitesh së kotit?

Kur gjithçka të vjen përsipër

dhe të duket sikur bota po përmbysset,

Mos gabo të heqësh dorë,

Sepse ai çast, është pikërisht kulmi

Ku gjithçka do ndryshojë.

Shpirti im, ti je libri manual i këtij universi:
Hape atë libër dhe lexo vetveten.

Skaji më i largët i universit, brenda teje, është veçse
një pikëlz e vogël.

Por ti as që je në dijeni të kësaj gjëje.

Për sa kohë që ti i mban shpresat tek Zoti,

Atëhere mos ki frikë nga asnjë shqetësim.

Teksa gjithkush përpiqet të kapet pas gjithçkaje që i
zë dora,

Ti besoji Zotit dhe shtrëngohu fort pas Tij.

Asnjë mëkat nuk mundet që kurrsesi

Të jetë më i madh se sa mëshira e Zotit,

Porse ti gjithsesi përpiqu të mos mëkatosh.

Mos u trishto!

Përktheu: Mehmet Disha

Biseda e Ebu Sufjanit *me mbretin e Bizantit*



Ibni Abasi (radijallahu anhu) transmeton: "Siç më ka lajmëruar Ebu Sufjani, në vitet kur Profeti ynë pati bërë një marrëveshje paqeje me Ebu Sufjanin dhe shumë mohues të Kurejshëve, në mes tyre ishte edhe një karvan që udhëtonte drejt Sirisë për tregti. Në atë kohë, Herakliu dërgoi lajm se e ftonte Ebu Sufjanin t'i shkonte në pallat. Ebu Sufjani, bashkë me të pranishmit e tjerë, u nisën menjëherë për të Herakliu. Në fakt, Herakliu dhe njerëzit e tij ishin të vendosur në zonën e quajtur Bejtul-Makdis. Herakliu i pati thirrur ata në kuvend. Rreth tij ishin të pranishëm edhe e gjithë paria e vendit. Mandej pati kërkuar që të vinte edhe një përkthyes. Përkthyesi tha: "Kush nga ju është më i afërt me atë njeri që thotë se është profeti i Zotit?"

- "Unë.", - u përgjigj Ebu Sufjani.

- "Ma sillni pranë, bashkë me shokët e tij, por ata të rrinë pas tij!", - urdhëroi Herakliu, për Ebu Sufjanin dhe ata që e shoqëronin. Pastaj, u drejtua nga ai që po përkthente dhe i tha:

- "Thuaju, (duke treguar me dorë Ebu Sufjanin) që unë do t'i pyes ata rreth atij njeriu dhe nëse më gënjen për ndonjë gjë, shokët e tij ta ndreqin, duke më thënë se po më gënjen!"

Më vonë Ebu Sufjani ka thënë: "Uallahi, sikur të mos ngurroja e të mos druhesha se shokët do të më vinin në pah se isha duke gënjyer, atë ditë do të kisha gënjyer. Ja se cila ishte pyetja e parë që më bëri:

- "Si është fisi nga e ka prejardhjen ai njeri?"

- "Ai vjen nga një fis shumë i mirë.", - iu përgjigja unë.

- "Në mesin tuaj, a ka pasur të tjerë që e kanë thënë këtë edhe më parë (se kanë qenë profetë të Zotit)?"

- "Jo.", - u përgjigja unë.

- "A ka pasur mbret ndër të parët e tij?"

- "Jo."

- "A i bindet fisnikëria e popullit, apo janë më shumë të dobët që i shkojnë nga pas?"

- "Të dobët janë ata që e ndjekin më së shumti."

- "Numri i atyre që po e ndjekin është duke u shtuar, apo duke u pakësuar?"

- "Vazhdimisht po shtohen.", - u përgjigja unë.

- "A ka të atillë, që pasi e pranojnë fenë e tij, e braktisin, pasi kanë vërejtur ndonjë gjë që atyre nuk u ka pëlqyer?"

- "Jo.", - iu përgjigja.

- "A e keni akuzuar ndonjëherë atë njeri, para se të shpallte profetësinë, se ju ka gënjyer për ndonjë gjë?"

- "Jo.", - iu përgjigja.

- "A ka qëlluar ndonjëherë që ai të mos e mbajë fjalën e dhënë?"

- "Jo.", - u përgjigja unë, - "por, hë për hë, ne kemi vendosur paqen me të, e nuk e dimë se çfarë do të bëjë."

Ebu Sufjani tregon: "Nuk dija se ç'të thosha më shumë, për t'ua ngatërruar mendjen." Herakliu vijoi të më pyesë:

- "Po mirë, a keni luftuar ju ndonjëherë më parë me të?"

- "Po.", - iu përgjigja unë.

- "Si kanë përfunduar ato luftëra që keni bërë?"

- "Me radhë, herë kemi dalë fitimtarë ne, herë ka qenë ai që na ka mundur."

- "Çfarë ju urdhëron ai njeri të bëni?"

- "Ai na urdhëron të adhurojmë Allahun, që është Një dhe i Vetëm, e të mos i bëjmë Atij asnjë shok në krijimin e asgjëje, si dhe që t'i braktisim të gjitha ato që na kanë mësuar të parët tanë. Ai na urdhëron neve faljen e namazin, përhapjen e së drejtës dhe të së vërtetës, si dhe që të ruajmë nderin e të duam fort familjen."

Herakliu u kthye nga përkthyesi dhe i tha këto fjalë:

"Të pyeta për prejardhjen e atij njeriu, e ti më the se ai është një njeri i fisëm. Profetët dërgohen përherë nga mesi i njerëzve më të fisëm. Ju pyeta, nëse ka pasur më parë në mesin tuaj, të cilët kanë pretenduar të njëjtën gjë, dhe ju më thatë se nuk ka pasur. Nëse do të më kishit thënë se po, ka pasur, atëherë do të mendoja se edhe ky është duke imituar fjalët e atij që ka dalë më përpara. Të pyeta, nëse ka pasur ndonjë mbret nga të parët e tyre. Ti më the se jo, nuk ka pasur. Nëse nga mesi i të parëve të tij do të kishte pasur ndonjë mbret, atëherë do të thosha se ky njeri është në kërkim të trashëgimit të mbretërisë së babait të tij dhe nuk do t'i jepja rëndësi më shumë nga sa është e nevojshme. Të thashë, a ka ndodhur ndonjëherë më parë që ju ta keni akuzuar atë njeri, se ju ka gënjyer. Përgjigja që më dhe ishte 'jo', nuk ka ndodhur. Unë e di mjaft mirë se ai njeri që nuk i gënjen njerëzit nuk ka se si të gënjejë karshi Zotit. Të pyeta, kush e ndjek më shumë atë, paria e njerëzve, apo më të varfrit e më të dobët, e ti më the që janë të dobët ata që e ndjekin më së shumti. Po, ata janë që bëhen zakonisht ndjekësit më besnikë të profetëve. Të thashë, po shtohen, apo po pakësohen dhe ti më the se janë duke u shtuar, e zakonisht kështu ndodh, që ata vetëm shtohen e shtohen, derisa feja të arrijë përsosmërinë e saj kështu do të vazhdojë. Unë të pyeta, 'a ka të atillë që e kanë pranuar fenë e tij, por që më pas kanë hequr dorë dhe janë kthyer në fenë e mëparshme, pasi ka pasur diçka që nuk u ka pëlqyer?' Ti më the jo, nuk ka pasur, sepse kështu ndodh kur besimi zë vend në zemrën e njeriut dhe aty nis të mbizotërojë paqja. Të pyeta a është kthyer ndonjëherë dhe nuk e ka mbajtur fjalën e dhënë. Përgjigja jote ishte jo. Të tillë janë profetët, nuk i gënjejnë njerëzit dhe nuk kthejnë kurrë nga ajo fjalë që japin. Po çfarë ju urdhëron juve të bëni ju pyeta. Ti më the se ju ka urdhëruar të adhuronit Allahun, të mos i bëni asnjë shok ose ortak Zotit në krijim; ju ka ndaluar që të adhuronit e të kryeni rituale për idhujt e krijuar prej jush vetë, të falni namazin, të jeni të drejtë, si dhe të jetoni një jetë që e dallon ndershmëria. Nëse të gjitha këto që the janë të vërteta, atëherë, nuk do të kalojë shumë kohë dhe ai do të bëhet zotëruesi i kësaj toke ku po shkelin këmbët e mia tani. Unë e dija që ai do të vinte. Por nuk prisja që të dilte nga mesi juaj. Sikur ta di se do të mund të mbërrija deri tek ai, do t'i pranoja të

gjitha vështirësitë me të cilat do të më duhet të përballem. Ah sikur të isha pranë tij e të isha unë ai që do t'ia laja këmbët!”

Mandej, Herakliu i kërkoi Dihjes (radijallahu anhu) që t'i jepte letrën që kishte çuar te sundimtari i Busras dhe përgjigjen që ai i kish kthyer. Në atë letër shkruhej:

“Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëplotit! Kjo është një letër e robit dhe të Dërguarit të Allahut, Muhamedit, për të parin e Bizantit, Herakliun.

Përsëndetje për të gjithë ata që kanë ndjekur rrugën e udhëzimit. E thënë siç e do fjala, unë të ftoj që të pranosh Islamin. Bëhu mysliman, që të mund të gjesh paqen e shpëtimin, në mënyrë që edhe Allahu i Madhërishtëm ta dyfishojë shpërblimin për ty. Nëse nuk e pranon, atëherë ta dish, se përgjegjësia do të jetë e jotja edhe për arsyen se populli nuk do të njihet me fenë e Allahut.

“... O njerëz të librit! Të biem në një mendje me njëri-tjetrin rreth asaj që na bashkon dhe që është e përbashkët dhe e drejtë për të dyja palët, si për ju, ashtu edhe për ne: 'Të mos adhurojmë askënd tjetër pos Allahut. Të mos i bëjmë Atij asnjë shok a ortak në krijim, e as nga ju, as nga ne të mos ketë asnjë njeri që adhuron tjetërkënd vetëm se Allahun.' Nëse e refuzojnë këtë thirrje, atëherë: Thuajuni: Të paktën bëhuni dëshmitarë

se ne jemi besimtarë, që u bindemi urdhrave të Allahut.” (Al 'Imran, 3/64)

Ebu Sufjani thotë: “Herakliu e tha ç'kishte për të thënë dhe, pasi e lexoi letrën, në mesin e njerëzve filluan të shtoheshin zhurmat dhe gumëzhima e zërave të tyre. Zërat filluan të ngriheshin. Ne na nxorën prej aty. Kur dolëm, unë u thashë shokëve: “Kjo puna e Ibni Ebi Kebshes (Ky ishte një ndër llagapet e Resulullahut nisur nga emri i burrit të mëndeshës së Tij dhe idhujtarët e Kurejshëve e përdornin atë veçanërisht për t'u tallur.) u zmadhua edhe më shumë, duke u bërë edhe më e rëndësishme. Atij filloi t'i frikësohej edhe mbreti i Bizantit. Besimi që kisha se këtej e tutje profeti do të dilte fitimtar nuk reshti së ekzistuari në mua, derisa Zoti e bëri Islamin të dashur për zemrën time.

Valiu i asaj kohe i Jerusalemit, i cili ishte njëherazi mik i Herakliut, peshkopi i të krishterëve të Sirisë, Ibnu-Naturi, ka treguar: “Kur Herakliu erdhi në Jerusalem, të gjithë e panë se ai ishte shumë i trishtuar. Njëri prej patriarkëve e pati pyetur: “Nuk po e kuptojmë, pse je bërë kështu?”

Herakliu ishte edhe falltar, pasi dinte të lexonte yjet. Kur i bënë këtë pyetje, ai u përgjigj: “Kam parë yjet dhe pashë se ai që është mbreti i të rrethprerëve është zhvendosur drejt qendrës. Cili nga vendet përreth jush është i banuar nga njerëz që bëhen synet?”

"Këtej rrotull i vetmi popull që bëhen synet janë hebrenjtë, nuk ka të tjerë. Po pse të të shqetësojë gjendja e tyre, ti mund t'u shkruash një letër njerëzve që kontrollojnë territoret e tua, e t'i vrasin të gjithë hebrenjtë që jetojnë nëpër to."

Ndërsa ata flisnin me këtë gjuhë, në praninë e Herakliut sollën një burrë, të cilin e kishte dërguar sundimtari i Gassanit. Ai i solli atij të reja lidhur me të Dërguarin e Allahut. Kur dëgjoi lajmet për Profetin (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) Herakliu tha:

"Shkoni e kërkoni njëherë, të mësoni a është ai rrethprerë, apo jo?" Kërkuan dhe i thanë se, po, ai ishte rrethprerë. I pyeti për arabët. A e kishin edhe ata zakon të bëheshin synet? Po, i thanë, edhe ata e kanë zakon, që të bëhen synet. Atëherë Herakliu tha: "Atëherë ky njeri do të bëhet i pari i atij populli, më në fund ka ardhur!" Mandej, Herakliu vendosi t'i shkruante një letër një miku të tij, që jetonte në Romë, e që ishte jo më pak i ditur se ai vetë dhe u nis të shkonte në Humus. Ende pa u larguar nga Humusi, nga miku i tij i mbërriti një letër. I shkruante se ai ishte i të njëjtit mendim me Herakliun, se ai, më në fund, ishte shfaqur dhe se ishte e vërtetë, ai ishte një profet. Pas kësaj, Herakliu ftoi në sarajet e tij në Humus të mblidhej gjithë paria e bizantinëve. Të gjithë i urdhëroi që dyert të qëndronin mbyllur.

Në fund, u ngjit në një vend të ngritur dhe filloi të fliste:


"O njerëz të Bizantit! A doni që të fitoni si lumturinë e kësaj bote, ashtu edhe lumturinë e amshuar në jetën e përtejme? Nëse doni që pasuria që keni të mbetet po në duart tuaja, atëherë duhet t'i bindeni atij profeti!"

Të gjithë sa ishin të pranishëm, sikur të ishin zebra të trembura, vërshuan drejt portave për t'u larguar së andejmi me një frymë. Kur Herakliu dëshmoi gjithë atë mllef prej tyre dhe e humbi shpresën se ata do të besonin, atëherë iu drejtua ushtarëve: "Sillini drejt meje."

- "Ato që ju thashë pak më parë ishin të gjitha fjalë për t'ju vënë në provë se sa të fortë e keni lidhjen me fenë tuaj dhe e dëshmovta me sytë e mi se sa fort të lidhur jeni ju me besimin tuaj."

Të gjithë të pranishmit u qetësuan dhe i thanë se kjo provë u kishte pëlqyer tej mase, kështu që u larguan prej aty duke ndierë edhe më shumë respekt për mbretin e tyre. Ja, me pak fjalë, kjo ishte gjendja përfundimtare e Herakliut."

**Shkëputur nga libri "Jeta e Sahabëve 1"
M. Jusuf Kandeheui
Botim i KMSH**



Rëndësia e gjuhës në jetën e një populli

Gjuha e një populli, vegël e shkëlqyeshme me të cilën njerëzit që banojnë në një pjesë të caktuar të rruzullit mundin me pas marrëdhënie midis syresh e me shfaq mendime e ndjenja të botës së tyre të brendshme, nuk mund të jetë një gjë e vdekur por, përkundrazi, është lëndë e zjarrtë që dalëngadalë mund të sajohet në formën që më tepër i përshtatet evolucionit të vazhdueshëm të popullit që e ka përdorur më parë, që të mund të bëhet në çdo kohë shprehja e gjallë e besnike e naltësimit të vet shpirtëror. Kështu, megjithëse duhet t'i shtrohet disa kushteve të caktuara e ligjeve fonetike, gjuha duhet të jetë përherë një gjë e përkulshme, e kthyeshme, e zonja me kënaq ndjenja harmonie të reja, me u pasurue me fjalë të reja që i lyp nevoja, pa humbun e pa braktisun, megjithëkëtë, ato fjalë që janë shprehja karakteristike e strukturës dhe e veçorisë së saj gramatikore e sintaksore, dhe pa marrë asgjë të huaj për të mos humbur në dëlirësi çka kishte me fitue në një terminologji të bollshme.

Gjuha asht një nga elementet etnike kryesore të një populli e prandaj ngrihet në një kuptim simbolik të lartë: asht si një flamur i gjallë e i dashtun i gjindve të unisuem nga zakone të përbashkëta, nga veti fizike e morale të veçanta, nga

përshkrime ndodhinash historike, asht si zani i tokës amësore që çohet lart nga malet, pyjet e detrat që përbajnë atdheun e dashtun. Asht burimi kryesor i traditës e i historisë dhe lejon që këto - shkas krenarie për një vend - të mos shfityrohen e dhunohen nga dashakeqësit ose nga interesat e kundërta të popujve të huaj.

Zbulimet arkeologjike, zë i shtremët por edhe i naltë i një të kalueme të largët, shndritin e përqethen me jetë të re kur fjala e stërgjyshave tanë të largët - mbërritur deri te na në formën e traditës me anë shkrimi a goje ose në veshjen ma shkencore të historisë - përshkruajnë ambëlsisht domethënien e atyre gërmadhve të pluhurosura.

As duhet harruar se nga gjuha e një populli të përparuar qytetnisht e shpirtërisht nxirren ato fjalë që, artistikisht të seleksionuese e të grumbulluese me vend, u japin madje jetë përmendoreve letrare që janë lumnit ma të shkëlqyeshme të një kombi.

Një dijetar pat thanë se "fjalët e një gjuhe janë si rrasa e ngjyrave të piktorit që e bajnë kuadrin të shëmtuar ose të bukur sipas vleftës e zotësisë së artistit". Dhe me të vërtetë ndër fjalët asht gama, delikate ose e ndezun, e ndjenjave tona, ndër to gjejmë hijet e dritat e mendimit tonë: fjalë të

thella e të menduara për të shprehun dyshimet, mundimet, ngadhënjimet e mendjes; fjalë të lehta e të shndritshme me të cilat shfaqet poezia dhe muzika që përshpërin në shpirt; fjalë bindëse, plot dashuni e paqe që çon nalt në qiell shikimin.

Kësisoj çdo popull gjen në idiomën e vet ushtimin trendës të shpirtit të përbashkët dhe pikërisht për këtë punohet si entitet kombëtar e bahet i njohur ndaj të huajve; pret si një fletë e shumëfuqishme ajrin e shekullit dhe shkon guximshëm me takue ledhën dehëse e të panjohur të lumnive të kohës së ardhme.

Në asht se, siç pat thënë Buffon-i "Stili asht njeriu" gjithaq e vërtetë asht se gjuha - në një shikim më të gjerë e më pak individual - asht kombi vetë, asht përshtjellimi njerëzor bamë ma kompakt e i pandashëm nga përbashkimi i jetës dhe i aspiratave nga trashëgimi i ngadhënjimeve dhe i vuajtjeve që i takon nga një e kaluar e përbashkët.

Pikërisht për këtë gja të gjithë patriotët e mëdhenj shqiptarë kanë ndimun përherë një dashtni të fortë e të devotshme ndaj idiomës sonë kombëtare, për këtë asht që popujt e ndryshëm ngadhënjyesh janë mundue më kot me ngjir zanin harmonik e të fuqishëm që prej kohëve të largëta të ilirëve e më parë nget drejt lumnive të arta të Shqipës, simbol fuqie e zemërgjanësie, etje lirie e kryenaltësie të papërkulun kurrë.

Që atë kohë shekujt pasuan shekuj dhe zbritësat e racës së fortë ilire njohën shumë herë peshën e idhët të sunduesit të huaj, por idioma e tyre megjithëse nuk mujt me pas një atë zhvillim e atë përsosuni që do të kishte mujt me i dhanë një regjim i lirë, u ruajt me xheloz të madhe si një gur i çmueshëm që vërtet nuk asht punuar, por që dora e aftë e mjeshtrit lehtësisht mund ta vërë në dukje shkëlqimin e fshehtë dhe ta bëjë që të shndritë me të njëmijë dritat rrënjyese tue gdhend e tue lëruet vetëm prej tepricave të kota.

Pra, një kështu Frashëri, Fishta, Mjeda – për me kujtue këtu vetëm të madhejt tanë të kohëve më të afërta - janë munduar me ambëlsinë e rreshit të tyre e due studjue me dashtni të gjithë problemet, me i dhanë gjuhës amësore një elegancë formash ma moderne, me përcaktue alfabetin e pasun dhe me kundruet në dritën e studimeve të përkujdsshme të etimologjisë e të filologjisë së krahasuese.

Në këtë mënyrë literatura shqiptare ka fillue me dhanë lule bukurie të mrekullueshme që kanë sjellë një erëkandje të re e të veçantë në kopshtin e gjanë e përherë të lulëzue të letërsisë së përbotshme.

Gjuha shqipe paraqet megjithëkëtë pika të errëta e probleme që lypin studime të kujdesshme e të thella për me sqarue rrugën që të çon drejt një solucioni të kënaqshëm. Duhet me u shpallë e përcaktue rregulla gramatike e sindaktike në mënyrë që - edhe pa qenë nevoja me i heq gjuhës plasticitetin e saj të duhun - të jenë prisa të drejtë për shkrimtarin, e që të mundi ky me lëviz mbi një bazë të qëndrueshme e të sigurt. Atëherë, e vetëm atëherë gjuha letrare ka me fitue një njësi ma të madhe stili, një strukturë ma koherente e të saktë.

E nxjerrë nga polimorfizma e tashme dhe e marrë nga një drejtim më linear do të jetë ma lehtë për artistin me i dhanë

gjuhës atë kthjelltësi dhe hollësi pende të aftë për ta ba një vegël tingëllimesh të përkryeme.

Na dimë se gjuha asht si një kuti ideale që ndan edhe aty ku caqet gjeografike nuk shënohen dhe asht si një urë ideale që bashkon edhe aty ku padrejtësia e njerëzve ka dashtë me nda vëllazën: - me e dashtë gjuhën amësore, me u mundue me e ba përherë e ma të bukur e të përsosun, me e përhapë dhe me vu në dukje melodi poezie ose proze të kulluara, me ba që me u këndue ambëlsisht e në formë përkëdhelëse dashnit familjare, janë të gjitha mënyra si me dëshmue nacionalizmin e vet.

Nuk asht vetëm me mjete fuqie që luftohet për me pohue madhnië dhe lirinë e atdheut të vet ndaj botës së qytetnueme, shpesh atdheut i jepet ma fort dritë prej shkëndijës së qetë e të padallueshme që shpërthen nga vepra e një shkrimtari ose oratori gjenial, se sa nga zhveshja e armëve e nga përdorimi i mjeteve të shkatërrimit që sado të shënjtueme që të jenë nga dilerësija e idesë që të ban me i rrok, prapë triumfi ose jo i tyne mvaret nga rrethanat e çastit.

Sallust-i thotë: Ma dobi ka me pas shteti nga argtimi i jem (puna ime letrare) sesa nga aktiviteti politik i të tjerëve.

Fatkeqësisht lakmia e të huajve, prepotenca e ma të fortëve, bajnë shpeshherë të nevojshëm që Atdheu të lypë prej bijve të vet një mbrojtje me armë dhe një flini jetësh mu në lulen e rinis, por edhe në këto çaste tragjikisht vendimtare për jetën e kombit, e madhe asht fuqia e oratorit, pohimi i mprehtë dhe objektiv i historikut, e deri fjalët e përvujtura por të thjeshta të gjuhës popullore kanë një ndikim të madh në shpirtin e turmës që tue naltue dashurinë ndaj Atdheut, tue e nxit atë në rrezikun ma të madh, zgjojnë tek ai atë rreshk flijimi që të çon në heroizmat ma të përlarta.

Dhe një punë e tillë asht vërtetue gjithmonë në të sjelljet e mëdha historike e shoqnore që kanë pasue kohët dhe, nëse ngandonjëherë njerëz të mbrapshtë kanë përdorur keq këtë dhunti të bekueme të Zotit tue e drejtue kah veprimtarina fatzeze e shkatërrimtare, të panumërt janë ata që për fat të mirë të njerëzimit kanë përdorur fjalën si një vegël mirësi ndaj vëllazënve të vet.

Asht pra një detyrë e përcaktue me e dashtë, me e lëvrue dhe me e përkrye gjuhën shqipe, këtë gjuhë që krenohet për një traditë lumnive të gjatë, në mënyrë që kjo të mundë me i dhanë theksimet e veta harmonike të mendimit të breznisë mocatave, tue vijue e denjë veprën e ndërmarrun prej parardhësve fisnikë; asht detyra jonë me e përpunue dhe me e naltësue gjuhën aq sa të jemi të sigurtë me i folë botës për këtë Komb të vogël, por të moçëm e qëndrueshmërisht trim, veçanërisht me dëshmue ndaj mbi përparimin shpirtëror të tij, ndërsa pasunit e tjera janë të brishta, ato të përpunueme prej shpirtit jetojnë në amshim. Na kujtohen me këtë rast fjalët sa të bukura aq edhe të drejta të Sallust-it se "përpjekjet e lume të zotëris mendore bahen të pavdekshme, si shpirti prej të cilit rrjedhin."

Jolanda Kodra
Botuar në revistën "Njeriu", nr. 3(27), shtator 1944.



MUDERRIZ HASAN EF. NAHI

(1905-1991)

Një ndër intelektualët, myderrizët, arsimdashësit e patriotët e shquar të popullit tonë të shekullit 20, nuk ka dyshim se ishte edhe Hasan ef. Islami, i njohur dhe i popullarizuar me emrin Hasan efendi Nahi, i cili tërë jetën e tij ia kushtoi arsimimit, edukimit dhe fisnikërimit të popullit në përgjithësi, kurse gjeneratave të reja në veçanti.

Megjithëqë pati fatin që të jetonte dhe të vepronte në kohë të vështira e kthesash të mëdha, dhe të përballej me regjime të ndryshme, Hasan ef. Nahi më përkushtim, devocion e urtësi, pasion e dashuri, iu përkushtua dhe i qëndroi afër popullit dhe bashkëvendësve të tij.

Biografi

Hasan ef. Nahi u lind më 12 mars 1905 në Gjakovë në një familje të madhe e me zë, nga babai Islami dhe nëna Xhemilja. Të parët e tij dalloheshin në kultivimin e traditës fetare e kombëtare. Babai i tij, Islam efendi ishte myderriz shumëvjeçar i Medresesë së Madhe të Gjakovës, kurse gjyshi i tij haxhi Jaha ka qenë hoxhë e personalitet i nderuar dhe i respektuar në Gjakovë e rrethinë.

Shkollimi

Hasan Nahi mësimet e para i mori në Gjakovë, së pari mbaroi Mektebin katërklasësh, e më pastaj për dymbëdhjetë vjet mësoi në Medresenë e Madhe të Gjakovës, të cilën e përfundoi me sukses dhe mori ixhazetnamenë. Në medresenë e Madhe të Gjakovës dhanë mësim myderrizë e pedagogë të shquar, të cilët këtë institucion e kishin shndërruar në një vatër të arsimit dhe edukimit kombëtar e fetarë dhe nga e cila dolën një plejadë e tërë e intelektualëve dhe personaliteteve që do të bëhen prijës të shumë proceseve me rëndësi jetike për popullin shqiptar.

Meqë Hasan efendi gjatë mësimave në medrese kishte treguar suksese dhe ishte dalluar në mësim, sidomos në lëndën e gjuhës arabe, pas kryerjes së saj u emërua si asistentë ligjërues i sintaksës së gjuhës arabe në këtë medrese.

Student në Kajro

Mirëpo, Hasan efendi nuk mbeti me kaq, por dëshira e madhe që të kryente studimet e larta e çoi në Egjiptin e largët të Mehmet Ali pashës. Kështu në vitin 1930 Hasan Nahi së bashku me bashkëvendësit e tij Mulla Tahir Brovinën dhe Mulla Asllanin u regjistrua në Universitetin "Al-Az'har", në Fakultetin "Kismi Ali", që do të thotë "Shkalla më e lartë e dijeve fetare".

Gjatë studimeve në Kajro Hasan efendi u tregua i përkushtuar e i zellshëm, dhe arriti që studimet t'i përfundonte në afatin më optimal dhe diplomoi në vitin 1934.

Në Kajro, përveç të tjerash, Hasan efendi u njoh dhe u shoqërua me shumë studentë gjithandej trojeve shqiptare dhe nga vendet e tjera të Ballkanit, të cilët, më vonë, pas kthimit në vendet e tyre, do të luain rol me rëndësi në jetën shoqërore, fetare dhe politike si: Sadik Bega nga Shqipëria, Bedri Hamidi nga Shkupi, Mumin efendi nga Kumanova, Mehmed Hanixhiq, Kasim Dobraqa e Besim Korkuti nga

Bosnja. Hasan efendi gjatë kësaj kohe u njoh dhe u miqësua edhe me poetin e njohur turk me prejardhje shqiptare Mehmet Akif Ersojin.

Kthimi në atdhe

Pas përfundimit të studimeve Hasan ef. Nahi, me gjithë mundësitë dhe rrethanat që të mbetej në Kajro, dashuria për vendlindjen dhe për Atdheun e bënë që të kthehej dhe dijte që kishte marrë t'i vinte në shërbim të popullit të tij. Për këtë Hasan efendi thoshte: "Kisha vetëm një dëshirë: Të jam në Kosovë dhe ta ushtroja profesionin tim në interes dhe në dobi të popullit tim".

Hasan efendi sejar-vaiz

Me t'u kthyer nga Kajroja, Ulema Mexhlisi me qendër në Shkup më 1935, Hasan ef. Nahin do ta emërojë në detyrën e Sejar-Vaizit. Në këtë detyrë Hasan efendi do të qëndroj për tri vjet ku dha një kontribut dhe u shqua për mënyrën e shpjegimit dhe të komentimit të mësimave të fesë islame. Një rëndësi të posaçme Hasan efendi në derset, vaziet dhe ligjëratat e tij, si në përqijthsi, hytbe e xhami, po ashtu edhe nëpër odat shqiptare dhe kudo që vinte, i kushtoi ngritjes së vetëdijes së masave të gjëra popullore për arsimim dhe edukim. Këtë e shpjegonte me binomin fe e atdhe dhe me nevojën për t'u shkolluar në gjuhën kombëtare.

Ligjëratat e Hasan efendit kudo që shkonte përcilleshin me interesim të madh nga ana e besimtarëve. Mënyra e shpjegimit, e ligjërimit, afërsia me popullin, sjellja e tij me modesti e urti dhe sidomos ligjërimi në gjuhën shqipe, bënë që Hasan efendi të mos ngelte një hoxhë dhe alim lokal i një vendi, por ai u bë i njohur gjithandej Kosovës dhe më gjerë.

Hasan efendi myderriz në Medresenë e Ferizajt

Kjo mbase ndikoi që më 1938 qytetarët e Ferizajt të kërkonin nga Hasan ef. Nahi që të merrte detyrën e myderrizit në medresenë e Ferizajt.

Mësimet në kohën sa ishte myderriz Hasan ef. Nahi, do t'i ndiqnin shumë nxënës jo vetëm nga Ferizaj dhe rrethina e tij, por vinin nxënës edhe nga Shkupi, sepse këtu mësimi bëhej në gjuhën shqipe.

Hasan efendi myderriz në medresenë e Mehmet Pashës në Prizren

Në prill të vitit 1943, Komuniteti Mysliman Shqiptar me seli në Tiranë, i cili organizonte dhe mbikëqyrte jetën fetare edhe në Kosovë, do ta emëroj Hasan ef. Nahin myderriz kryesor dhe drejtues të medresesë "Mehmed Pasha" të Prizrenit. Në këtë detyrë ai do të qëndroj deri në vitin 1948 kur kjo medrese me një traditë afro katër shekulllore në mënyrë arbitrare dhe me ca arsytetime banale do të mbyllet nga pushteti socialist komunist që dalë ngadalë po nguliste thonjtë në Kosovë.

Për mbylljen e medresesë, myderriz Hasan Nahi, thoshte: "Më thanë, se nuk na duhej një shkollë e tillë në Kosovë, mjaft e keni një në Sarajevë. T'i veshë drynin një medreseje të tillë do të thoshte: Ndal diturive fetare në gjuhën shqipe".

Hasan efendiu kryemyfti i Dukagjinit

Në qershor të viti 1943 Komuniteti Mysliman Shqiptar me seli në Tiranë, Hasan ef. Nahin do ta emëroj Kryemyfti të Zonës së Dukagjinit. Detyrë kjo të cilën do ta kryej deri në vitin 1946 kur edhe suprimohet ky funksion.

Pas mbylljes së medresesë "Mehmed Pasha" më 1948, Hasan ef. Nahi do të shpallej nga pushteti si person i papërshtatshëm dhe nuk do t'i lejohej të ushtronte ndonjë funksion tjetër përveçse të imamit, për se deri më 1958 Hasan ef. Nahin e gjejmë si imam në Gjakovë.

Në një studim të mbështetur në dokumente arkivore të historianit Hakif Bajrami jepen të dhëna për planet sekrete të UDB-së për likuidimin dhe shpërnguljen me dhunë të ulemave të Kosovës, ndër të tjerash, edhe për Hasan ef. Nahin, ku thuhet:

"Prej të gjithë ulemave, si ideologu më "i rrezikshëm", që me mësimet e tij nuk do të lejonte që shqiptarët të shpërngulen në Anadoll, ishte cilësuar Hasan efendi Nahi. Pse të mos e themi se për likuidimin e tij ishte angazhuar kriminelin Voja Vojvodiq, që punonte në Pejë, por që i kishte agjentët e vet kudo. Po mënjëria e efendi Hasan Nahit do të triumfojë".

Hasan efendiu përkrahës e sensibilizues i shkollës shqipe

Gjatë kësaj kohe Hasan efendiu do të vihet me tërë qenien në përkrahje dhe të masivizimit të arsimit në gjuhën shqipe. Ai për këtë nuk la asnjë rast dhe as vend pa e përmendur rëndësinë, vlerën dhe nevojën e shkollimit në gjuhën amtare.

Dhe jo vetëm kaq, por përveç se kishte ngritur zërin kundër mbylljes së medresesë "Mehmet Pasha" në Prizren, ai fuqishëm kishte dalë në mbrojtje të Gjimnazit të Gjakovës dhe shkollës shqipe në përgjithësi në vitet e pesëdhjeta.

Kështu në qershor të vitit 1956 në një tubim me struktura e pushtit të asaj kohe, e që për synim kishin

që gjimnazin e Gjakovës ta bënin shkollë profesionale (teknike). Hasan efendiu atë kohë që i pari që ashpër e kundërshtoi këtë nisëm të pushtetarëve të atëhershëm. Hasan efendiu në bashkëbisedim me pushtetarët e atëhershëm, argumentoi fuqishëm se Gjakovës dhe shqiptarëve në përgjithësi, si popullsia më e prapambetur, asokohe, në Jugosllavi, u nevojitej pikërisht gjimnazi, si shkollë që do të krijonte kuadro të afta për të vazhduar studimet në Universitete.

Ndërsa gjatë viteve 60-70, Hasan efendiu përkrahu fuqishëm klasën intelektuale shqiptare në odisejaden e tyre për të siguruar të drejtën e shqiptarëve për të pasur një universitet ku do të shkolloheshin shqiptarët e ish Jugosllavisë në gjuhën e tyre amtare.

Sa ishte i përkushtuar Hasan efendiu në përkrahjen e shkollës shqipe më së miri mund të kuptojmë nga shënimi në të përditëshëm e asaj kohe "Rilindja" të datës 2 tetor 1970, në një kronikë për kontributin e Hasan efendiut për shkollën shqipe shkruan:

"Hasan efendi Nahi dha 10 mijë dinarë për shkollat". Kronika ka të bëjë me një aksion të kohës për të ndihmuar përhapjen e shkollave shqipe nëpër Kosovë. Për këtë arsye, në këtë kronikë shkruan: "Që në ditën e parë të regjistrimit të huasë për ndërtimin e objekteve shkollore, Hasan ef. Nahi profesor i gjuhës arabe në medresenë e mesme "Alaudin" në Prishtinë i regjistroi 10.000 dinarë të rinj. Hasani që është shumë i nderuar, jo vetëm prej besimtarëve por edhe nga të gjithë ata që e njohin është i njohur si dashamirë i flaktë i arsimit". Më tutje, në kronikë, thuhet: "Qëllimi kryesor, thotë Hasan efendiu, ka qenë t'i këshilloj, ndihmojë dhe udhëzojë besimtarët që fëmijët e tyre t'i shkollojnë, t'u japin dritë e dije". Autori i kronikës nuk la pa përmendur faktin se Hasan efendiu ka shkolluar të gjithë fëmijët e vetë.

Hasan efendiu myderriz në medresenë "Alaudin" në Prishtinë

Më 1958, Hasan ef. Nahi do të caktohet profesor për lëndën e Kur'an-it dhe lëndët e tjera fetare në

medresenë e Ulët të Prishtinës. Gjatë kësaj kohe Hasan efendi përveç angazhimit të tij si myderriz, u angazhua pareshtur për shndërrimin e medresesë nga e ulët në medrese të mesme, e barazvlershme me gjimnazet e kohës.

Mirëpo, puna dhe aktiviteti i Hasan efendiut nuk kishte mbetur pa u rënë në sy strukturave të atëhershme politike, të cilët e përcillnin me shumë kujdes çdo aktivitet të myderriz Hasan efendiut, por i cili me asnjë çmim nuk hiqte dorë nga pikëpamjet dhe misioni i tij.

Si pedagog në medrese Hasan ef. Nahin do ta shquajnë përkushtimin i tij ndaj nxënësve dhe sjelljet prindërore ndaj tyre si dhe metodologjinë e mësimdhënies. Është i fundit nga brezi i hershëm i ulemave që në mësim aplikonte një metodë klasike, si akademi, me rastin e mësimdhënies.

Detyrën e profesorit në medresenë "Alauddin" të Prishtinës, do ta kryej për 20 vjet rresht, deri në korrik të vitit 1978. Gjatë kësaj kohe Hasan efendiut kishte arritur t'i nxirrte tri gjenerata me nxënës që vinin po thuajse nga të gjitha rrethet e Kosovës, nga Maqedonia, Mali i Zi dhe Sanxhaku, gjenerata këto që edhe sot e kësaj dite njihen si gjeneratat e Hasan ef. Nahit.

Gjatë punës së tij në medrese dhe nga përvoja me nxënës, Hasan ef. Nahi kishte vënë re nevojën e patjetërsueshme se shqiptarët duhet të kishin edhe një fakultet ku Islami do të mësohej në gjuhën shqipe. Ky vizion dhe dëshirë jo vetëm e Hasan efendiut, por e gjithë ulemasë së gjeneratës së tij, u bë realitet në fillim të viteve të nëntëdhjeta.

Hasan efendiut përkthyes i Kuranit

Hasan ef. Nahi ishte i vetëdijshëm dhe i përgjegjshëm se besimtarëve myslimanë shqiptarë u duhej përkthimi i Kur'an-it në gjuhën e tyre, në mënyrë që t'i kuptojnë më mirë e më drejtë mësimet dhe porosit e Allahut xh.sh. Prandaj, megjithëqë i shtyrë në moshë dhe në pension, por i vetëdijshëm për rëndësinë që ka përkthimi

i Kuranit në gjuhën shqipe, më 1978 nisi të përkthente në gjuhën shqipe ajetet e para të kaptinës "El-Fatiha" për të vazhduar deri në ajetin e fundit të kaptinës së fundit të Kur'an-it Fisnik, përkthim ky që doli nga shtypi më 1988. Përkthimin e Kur'an-it, myderriz Hasan ef. Nahi e kuptonte si një obligim fetar dhe kombëtar. Për këtë çështje në hyrje të përkthimit të tij të Kur'an-it, do të shkruaj: "Është detyrë e dijetarëve fetarë për ta përkthyer Kur'an-in në gjuhën e popullit të vet."

Përkthimi i Kur'an-it në gjuhën shqipe nga Hasan ef. Nahi njihet si një ndër përkthimet më popullore në trojet shqiptare dhe i cili ka përjetuar disa ribotime në Kosovë dhe Shqipëri dhe lexuesit shqipfolës nga Instituti i Mendimit dhe Qytetërimit Islam i është ofruar edhe në versionin audio vizual në format DVD.

Hasan efendiut ndërroi jetë më 5 shkurt 1991, në Prishtinë, duke u ndarë kështu nga familja e tij e dashur, nga ish nxënësit e tij që aq shumë e deshën dhe i deshi, u nda nga xhematlinjtë e tij që aq shumë e respektuan dhe e nderuan. Hasan ef. Nahi u nda nga kjo botë në të cilën mbolli shumë fidanë shpresëdhënës e frytësjiellës dhe të cilës i dha shumë punë të hairit e të bereqetshme, ashtu edhe siç jetoi ashtu edhe vdiq, i dalluar në kuptimin e plotë të fjalës, i thjeshtë e modest dhe admirues i zjarrtë i arsimit dhe i së vërtetës, popullor në çdo pikëpamje, me virtyte e cilësi të larta prej myderrizi, dijetari e intelektualit të nderuar.

Hasan ef. Nahi pas vetës kishte lënë një bibliotekë të pasur me libra e dorëshkrime në gjuhë të ndryshme, disa prej tyre të trashëguara nga ish të parët e tij myderrizët e Medresesë së Madhe të Gjakovës.

Vdekja e Hasan ef. Nahit ishte humbje e madhe për të gjithë ne, por në të njëjtën kohë vepra dhe kontributi i tij mbeten një kandil i pashuar dhe një pishtarë që ndriçon.

Hasan ef. Nahi edhe njëzet vjet pas vdekjes së tij është edhe sot një frymëzim i gjallë për ish nxënësit e tij dhe për të gjithë ata që e njohën, madje jo vetëm për ato që la fjala dhe pena e tij, por edhe për karakterin dhe personalitetin e shquar unikal e origjinal.

PËRSE TË RINJTË I FRIKËSOHEN MARTESËS?

Çfarë është martesë?

Njeriu është një qenie me nevoja të caktuara. Njëra nga këto është dhe nevoja për të krijuar një lidhje, pra për t'u lidhur me dikë. Nevoja të tilla janë si nevojat që kemi për t'u ushqyer apo për të pirë ujë. Kur vjen koha e duhur, kur maturohemi si fizikisht ashtu dhe emocionalisht, pikërisht atëherë e ndjehmë të nevojshme të lidhemi me dikë dhe të martohemi. Sigurisht që mënyra më e mirë e ruajtjes së kësaj nevoje është institucioni martesor. Martesa është një koncept i pranuar në të gjitha fetë, shoqëritë, kulturat dhe popujt e ndryshëm. Në të njëjtën kohë ajo konsiderohet një institucion social, sepse njeriu, në fund të fundit, është një qenie sociale. Kjo është dhe arsyeja pse përpiqet të zgjedhë martesën për të krijuar një lidhje.

Martesa siç ka anën sociale ka edhe anën individuale. Në martesë të dyja palët plotësojnë njëra-tjetrën ose përpiqen ta arrijnë këtë. Bashkë me lidhjen me bashkëshortin hyjnë në skenë edhe shumë role të tjera. Bashkë me familjen tënde, familjen e bashkëshortit përftohen edhe role të reja.

Pse të rinjtë e sotëm qëndrojnë pak më larg martesës?

Në kohërat e sotme shohim një rritje të moshës së martesës dhe këtë e lidhim me ndërgjegjësimin e njerëzve. Ky ndërgjegjësim nuk ka lidhje me njohjen apo mosnjohjen

e vetes. Ndërgjegjësimi lidhet edhe me vëzhgimin e disa shembujve të mëparshëm të jetës martesore. Një tjetër shkak është edhe ankthi apo shqetësimi i tepruar rreth martesës, sepse ajo nuk dihet, askush nuk mund ta parashikojë të ardhmen dhe se çfarë e pret në martesë. Një tjetër faktor është dhe përgjegjësia. Ndjenja e përgjegjësise nuk është një ndjenjë, e cila po transmetohet nga prindërit te fëmijët në ditët e sotme. Brezi i ri fatkeqësisht nuk njuh sensin e përgjegjësise. Personat të cilët nuk janë mësuar të marrin përsipër përgjegjësi para martesës e dinë se u duhet të mbajnë përgjegjësi kur të martohen dhe për rrjedhojë frikësohen e i shmangen martesës.

Shpeshherë planet e karrierës prishin planet e martesës. Me mendimin se ja të mbaroj këtë, edhe atë koha kalon dhe sa më shumë që kalon koha aq më e vështirë bëhet vendimmarrja për martesë. Në të vërtetë çdo njeri mund t'i bëjë punët e planet e karrierës edhe i martuar, madje i martuar është edhe i mbështetur nga bashkëshorti/ja.

Ndryshimi mes brezit të vjetër dhe brezit të ri është shumë i madh. Në marrëdhëniet e sotme njerëzit kërkojnë natyralitetin, duan të jenë vetvetja, të jenë të sinqertë. Nëse ky sinqeritet do të ndërthurej me informimin e duhur, atëherë do të kishim një marrëdhënie më të shëndetshme. Sinqeriteti buron nga shpirti dhe sa më shumë të jemi të



sinqertë aq më e madhe do të jetë mundësia e krijimit të një marrëdhënieje të pastër e solide.

Çfarë këshille mund t'u japim prindërve të të rinjve?

Bashkë me ardhjen në jetë të fëmijës prindi duhet ta pranojë se tashmë Zoti i Madhëruar i ka falur një qenie të pavarur, ndryshe nga ai. Atë duhet ta shohim si një qenie të veçantë, unike dhe ta përgatisim për periudhën e pjekurisë. Pike së pari si prind duhet të bëjmë të pamundurën për të edukuar një të rritur të shëndetshëm. Nëse ai rritet shëndetshëm dhe me baza të forta morale, atëherë dhe martesë e tij do të jetë e tillë. Shpirti ta do që çdo martesë të funksionojë. Edhe në rastet kur bëhet fjalë për divorc prindi duhet të jetë pranë fëmijës, ta mbështesë në çdo hap dhe ta ndihmojë në kalimin e situatave kritike. Nëse ne arrijmë të edukojmë individë të pavarur të cilët arrijnë të marrin vendime të drejta e të shëndetshme, atëherë nuk duhet të frikësohemi nga asnjë zgjedhje e bërë nga ana e tyre.

Ndonjëherë nënat bëjnë një gabim, tentojnë të përfshihen në martesën e fëmijëve të tyre. Madje këtu mund të shtojmë edhe tezet apo hallat. Fëmija sheh dhe ndjen çdo hap rreth martesës që në fëmijërinë e tij dhe si rrjedhojë ndikohet negativisht. Ai rritet me frikën ndaj martesës dhe kjo frikë bëhet shkak i mosmarrjes së

vendimit të martesës.

Nuk ka marrëdhënie edhe më të mirë!

Kur bëhet fjalë për martesën mund të themi se nuk ekziston martesë më e mirë se kjo që ke. Sigurisht që mund të bëhet më e mirë vetëm se duhet zgjedhur koha dhe vendi i duhur. Është shumë e lehtë të shkatërrosh diçka të ndërtuar më parë, por shumë e vështirë ta vazhdojë atë. Pikërisht në këtë pikë të vazhdimit individ duhet të qëndrojë i fortë dhe i vendosur. Kur bëhet fjalë për martesën mendojmë edhe për fëmijët që mund të lindin nga kjo lidhje apo jo? Për të rritur breza të shëndetshëm ne duhet të vazhdojmë martesën, duke marrë përsipër përgjegjësitë e duhura. Të rritur të shëndetshëm do të thotë fëmijë të shëndetshëm, do të thotë një e ardhme e sigurt. Nuk duhet të frikësohemi nga vendimet dhe zgjedhjet e personave të konsoliduar.

Le të mos harrojmë se në martesë ekzistojnë tre persona, unë, ti dhe lidhja jonë. Lidhja është si një fëmijë që ushqehet nga veprimet tona. Sa më të sigurt të jemi ne aq më e sigurt do jetë edhe lidhja jonë.

Aisa Kokiçi

Kujdesi për jetimin



Profeti ynë i dashur, paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të, ndjente një dhembshuri të madhe ndaj fëmijëve jetimë. Ndaj tyre ishte shumë, shumë dashamirës. Ngaqë dhe vetë ai u vetëm dhe e kuptonte fare mirë se ç'do të thotë të jesh jetim. E dinte shumë mirë se sa e dhimbshme dhe e vështirë ishte kjo ndjenjë. Nga mëshira e madhe që kishte për jetimët, vazhdimisht i mbronte ata dhe kur atyre u bëhej ndonjë padrejtësi, gjithmonë kërkonte të drejtat e tyre.

Fëmijët e shokëve të tij, të cilët binin dëshmorë nëpër luftëra mbeteshin jetimë Profeti a.s. interesohej shumë, kujdesej për ta, kurrë nuk i linte vetëm dhe ua plotësonte nevojat e tyre. Disa prej tyre i merrte nën kujdestarinë e tij.

Teksa po dilte nga xhamia pas namazit të Bajramit, Profeti a.s., pa fëmijët që po luanin me gaz e hare. Ndërkohë i tërhoqi vëmendjen një fëmijë i mbështetur pas murit, me rroba të grisura e në gjendje të mjerueshme, duke qarë. Iu afrua atij dhe i tha:

- Vogëlush! Çfarë ke? Pse rri i mërzhitur? Përse nuk luan me shokët e tu?

Fëmija ishte jetim. Babai i tij kishte rënë dëshmor në luftën e Uhudit, nëna e tij ishte martuar me një tjetër dhe ai kishte mbetur i vetëm. Profeti ynë i dashur i kapi dorën dhe i ledhatoi kokën duke i thënë:

-Pse qan? A nuk do që babai yt të jem unë, nëna jote Aishja dhe motra jote të jetë Fatimja?

Fëmija nga gëzimi i madh sa s'po fluturonte. I emocionuar ia ktheu:

- E si të mos jem i kënaqur, o Profet i Zotit?

Profeti e mori fëmijën dhe e çoi në shtëpinë e tij. E ushqeu dhe e veshi. Tanimë që ishte i ngopur dhe i mbrojtur, doli përsëri që të luante me fëmijët e tjerë. Pse të mos gëzohej? Babai i tij kishte ikur në Parajsë (Xhenet), por tani në vend të tij ishte babai më i mirë në botë.

Kur fëmijët e tjerë vunë re tek ai ndryshimin, u mblodhën rreth tij dhe me kuriozitet e pyetën:

-Ti më parë vetëm qaje, kurse tani je ndryshe. Vallë ç'të ka ndodhur?

- Isha i etur, u ngopa, isha i zhveshur, u vasha, isha jetim, tani Profeti i Zotit është

babai im dhe Aishja është nëna ime, - tha ai i lumtur.

Pas kësaj, fëmijët duke lakmuar fatin e shokut të tyre jetim thanë:

-Ah, sikur dhe baballarët tanë të ishin dëshmorë dhe ne të kishim fatin e të pasurit një baba të tillë!

Fëmija ndenji pranë Pejgamberit a.s. derisa ai ndërroi jetë.

Sikur vetëm kokën ti ledhatosh një jetimi fiton një sevap shumë të madh dhe pikërisht ky gjest është sihariq për Xhenetin.

Profeti ynë a.s. shprehet kështu për këtë sevap të madh:

"Kush ledhaton kokën e një jetimi, vetëm për të fituar kënaqësinë e Zotit, për të ka aq sevape sa flokët që prek dora e tij. Ai njeri që i bën mirësi jetimit pranë tij, në Xhenet do të jetë afër meje si këto dy gishta" dhe më pas tregoi afërsinë e dy gishtave.

Kush e blen këtë skllav?

Profeti a.s. kishte një skllav me emrin Zahire. Zahire jetonte në shkretëtirë. Herë pas here, ai i sillte të Dërguarit të Allahut dhurata nga lulet dhe frutat e shkretëtirës. Pejgamberi gjithashtu e gëzonte me dhurata, të cilat ishin të nevojshme në shkretëtirë. Zahire ishte njëri ndër sahabet me të cilin Profeti bënte shumë shaka. Dhe thoshte për të:

- Zahire është shkretëtira jonë, ndërsa ne jemi qyteti tij.

Zahire i cili merrej me tregti, sërish një ditë kishte ardhur në qytet për të shitur ca gjëra. I Dërguari i Allahut, pa e parë ai, i shkoj nga mbrapa dhe pasi e kapi nga krahët, i mbylli sytë. Zahire i shqetësuar, duke thënë:

- Kush je ti? Më lëshol u kthye mbrapa.

Kur pa që ishte i Dërguari i Allahut u getësua dhe e vendosi kokën në kraharorin e Tij të mëshirshëm.

I Dërguari i Allahut e vazhdoi shakanë duke pyetur:

- Kush e blen këtë skllav?

Dhe Zahire iu përgjigj:

-Nuk do të gjeni ndonjë blerës, o i Dërguar i Allahut. E çfarë vlere kam unë?!

I Dërguari i Allahut tha:

-Ndoshta në pamje ashtu je, por tek Allahu je një rob (skllav) i shtrenjtë e me vlere të madhe.



BOTIMET KMSH

MUND T'I GJENI PRANË LIBRARISË "MIQTË E LIBRIT"



WWW.KMSH.AL



BOTIM I RI